



**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË**

## **RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor**

**“Inxhinieri Agromjedisi”**

**i**

**Institucionit të Arsimit të Lartë**

**“Universiteti Bujqësor i Tiranës”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. As. Mihallaq Qirjo
2. Dr. Taulant Bino

Korrik / 2019

## PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM

### Përshkrim përmbledhës

Programi i ciklit të parë të studimit “Inxhinier i Agromjedisit është hapur nga MASH me Shkresë nr 2713 Prot, datë 03.07.2001 “ Miratim për hapjen e strukturave të reja”. Me Urdhër të MAS, Nr 405, datë 08.09.2017 “Për Rregjistrimin e formave të diplomave “Bachelor”; “Master Profesional” dhe “Master i Shkencave” të Universitetit Bujqësor të Tiranës, emërtimi i këtij programi është Bsc në “Inxhinier i Agromjedisit”. Nga biseda me drejtuesit e këtij Institucioni si me Dekanin e Fakultetit, me Zv Dekanen për anën mësimore dhe me Shefin e Departamentit, emërtimi i këtij programi bie ndesh me Udhëzimin Nr 15, datë 06.04.2011 të MASH “ Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin Nr 5, datë 18.02.2009 “Për përmbajtjen dhe formën e diplomës së lëshuar nga Institucionet e Arsimit të lartë”. Sipas pikës së I të këtij Udhëzimi, Emërtimi i diplomës së lëshuar, sipas programeve të miratuara të studimit dhe cikleve të studimit, të jetë: a. “Bachelor” në .... (fusha e arsimit të kryer). Mbështetur në LAL 80/2015, neni 73, pika 3 citohet shprehimisht: në përfundim të programeve të ciklit të parë lëshohet diploma ‘Bachelor’ në fushën e arsimit të kryer. Në këto kushte, Dekani i Fakultetit ka paraqitur në ASCAL një shkresë ku citon se për vlerësimin në kuadër të akreditimit të këtij programi studimi, emërtimi i këtij programi të konsiderohet Bachelor në ‘Inxhinieri Agromjedisit’. Ndërkohë, UBT i është drejtuar me shkresë MASR ku i kërkon rregjistrimin e formës së diplomës dhe të suplementit të diplomës me emërtimin “Bachelor në “Inxhinieri Agromjedisit”.

Vlen të theksohet se i gjithë dokumentacioni i dorëzuar në ASCAL nëpërmjet Dosjes së Vetvlerësimit (DVV) i përmbahet emërtimit të programit të studimit: Bachelor në ‘Inxhinier i Agromjedisit’, pasi akoma nuk ka nga Minsitria përgjegjëse, ndonjë shkresë zyrtare ku emërtimi i programit të ndryshojë në “Inxhinieri Agromjedisit”

Për sa më sipër, deri në marrjen e një përgjigje zyrtare nga MASR për emërtimin e këtij programi studimi, për mos penalizim të studentëve që do të diplomohen dhe për arsye të vlerësimit për herë të parë të programit të studimit për akreditimin e tij, GVJ do ti referohet emërtimit sipas LAL 80/2015 si dhe kërkesës së bërë nga Dekani i Fakultetit drejtuar ASCAL, ku kërkohet që ky program studimi të vlerësohet me emërtimin Bsc në “Inxhinieri Agromjedisit”

Programi i hapur pranë Departamentit e Agromjedisit dhe Ekologjisë DAME, në Universitetin Bujqësor të Tiranës synon përgatitjen e specialistëve në fushën e mjedisit dhe të bujqësisë, dy fusha të rëndësishme për zhvillimin e vendit. UBT përfaqëson një prej institucioneve akademike me përvojë unike në vend në fushën e bujqësisë dhe me një staf pedagogjik dhe kërkimor të krijuar ndër breza, të cilët vijnë në kontribojnë në programin e këtij cikli studimi.

Programi i studimit i ofruar në Bachelor Inxhinieri Agromjedisit, bazuar në dokumentacionin e paraqitur prej institucionit të UBT, dhe vizitës në institucion konfirmon se ai është ndërtaur mbi një përvojë të gjatë institucionale, të vlerave akademike dhe ato të kërkimit shkencor.

Stafi drejtues dhe pedagogët përbëhen nga personeli akademik dhe ndihmës të kualifikuar, që punojnë me kohë të plotë dhe të përfshirë në aktivitetin kërkimor shkencor që garanton vijimësinë afatgjatë të burimeve akademike.

Programi i studimit është ndërtuar mbi bazën e kriterëve dhe standarteve të përcaktuara qoftë në tipologjinë e lëndëve ashtu edhe në ngarkesën e orëve dhe krediteve. Koncepti i ndërtimit të programit të studimit bazohet në thellimin e njohurive në drejtime më specifike duke kaluar nga viti i parë në atë të tretë. Ai u jep mundësi studentëve të transferohen në programe të tjera apo të thellojnë studimet e tyre më tej në ciklin e dytë.

Nxitja e përfshirjes në programe shkëmbimi, aktivitete shkencore apo punë të pavarur ndihmon studentët të aftësohen për tu përthithur në tregun e punës. Infrastruktura është e kënaqshme ndonëse pajisja më e mirë e laboratorëve mësimorë duhet vlerësuar si prioritet në të ardhmen, varësisht edhe mbështetjes më të madhe financiare të institucionit për kërkimin shkencor. Ndonëse institucioni ka bërë hapa në gjurmimin e tregut të punës, është i nevojshëm thellimi i mëtejshëm i njohjes së tij në mënyrë që rishikimi i planeve mësimore të ndjekë tendencat e këtij tregu.

Njësia bazë, DAME, në kuadër të UBT, ka të përditësuara rregullore dhe dokumentacionin bazë të nevojshëm për funksionimin e programit. Sistemet e ndryshme të menaxhimit të burimeve njerëzore, infrastrukturës, informacionit, etj janë funksionale dhe plotësojnë kushtet e domosdoshme dhe të nevojshme për të pasur program që përmbush kriteret e përcaktuara.

## **Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm**

Grupi i vlerësimit të jashtëm i përbërë prej Prof. Asoc. Mihallaq Qirjo dhe Dr. Taulant Bino është përzgjedhur nga lista e ekspertëve të jashtëm të vlerësimit, miratuar nga Bordi i Akreditimit. Ekspertët e përzgjedhur morën pjesë në trajnimin e organizuar nga ASCAL më 03.05.2019, mbi kryerjen e vlerësimit të jashtëm të programeve të studimit bazuar në standardet e reja të sigurimit të cilësisë.

Nëpërmjet sistemit elektronik AMS të ofruar nga ASCAL, ekspertët u njohën me Raportin e Vlerësimit të Brendshëm dhe gjithë dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga Institucioni i Arsimit të Lartë që po vlerësohet. Në datat 20 dhe 23 Maj 2019, Grupi Vlerësimit të Jashtëm kreu vizitën dyditore në UBT dhe kreu një sërë takimesh, intervistash e vëzhgimesh me stafin akademik dhe ndihmës në mjediset e institucionit.

Raporti i përgatitur përmbledh rezultatet e shqyrtimit të dokumentacionit dhe informacionit të mbledhur gjatë vizitës në këtë Institucion.

Menaxhere teknike e ndjekjes së këtij programi studimi, është Specialistja e ASCAL, Znj Suela Kromidha

Më datë 15.07.2019 nëpërmjet sistemit AMS por edhe me shkresë zyrtare, është dërguar në Institucion Draft RVJ. Me shkresë Nr 251 prot, datë 23.07.2019 “Në lidhje me akreditimin e programit të studimit Bachelor në ‘Inxhinieri Agromjedisi’”, vjen nga UBT përgjigja për Draft RVJ, nëpërmjet sistemit AMS. UBT nuk ka asnjë koment për këtë Draft Raport. Për sa më sipër, Draft RVJ merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm dhe firmoset nga Ekspertët e vlerësimit

## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Inxhinieri Agromjedisi”

### I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	<p>Programi i ciklit të parë të studimit “Inxhinieri Agromjedisi”, hapur pranë Departamentit e Agromjedisit dhe Ekologjisë DAME, në Universitetin Bujqësor të Tiranës synon përgatitjen e specialistëve në fushën e mjedisit dhe të bujqësisë, dy fusha të rëndësishme për zhvillimin e vendit.</p> <p>GVJ vlerëson se bazuar në dokumentacionin e paraqitur prej institucionit të UBT, të vizitës në institucion dhe shqyrtimit të materialit të depozituar (DVV) për akreditimin e këtij programi Bachelor, ky program studimi gjendet në përputhje me interesat kombëtare të vendit, kryesisht në përgatitjen e specialistëve të fushave të zhvillimit të bujqësisë dhe mjedisit. Dokumentacioni mbështetës përbëhet nga Statuti i UBT, Plani strategjik 2016-2025.</p> <p>Ky kriter është referuar qartë në takimet me drejtuesit e institucionit, stafi pedagogjik dhe kërkimor si dhe vetë studentët.</p> <p>Dokumentacioni mbështetës:</p> <p>Aneks 1: Mendimi i Dekanit</p> <p>Aneks 2.1: Statuti i i UBT-së_2017</p> <p>Aneks 3.1: Plani strategjik i UBT 2016-2025</p> <p>Aneks 5.1: Rregullore e studimeve universitare_2017</p> <p>Aneks 6.1: Rregullore e brendshme e FBM</p>
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>UBT përfaqëson një prej institucioneve akademike me përvojë unike në vend në fushën e bujqësisë dhe me një staf pedagogjik dhe kërkimor të krijuar ndër breza, të cilët vijojnë të kontribuojnë në programin e këtij cikli studimi.</p> <p>Programi i studimit i ofruar në Bachelor Inxhinieri Agromjedisi, bazuar në dokumentacionin e paraqitur prej institucionit të UBT, dhe vizitës në institucion konfirmon se ai është ndërtuar mbi një përvojë të gjatë institucionale, të vlerave akademike dhe ato të kërkimit shkencor.</p> <p>Stafit drejtues dhe pedagogët konfirmojnë vijimin e punës së institucionit në këtë program në linjën e vlerave të ndërtuara dhe konsoliduara sikundërse shprehen edhe në dokumentacionin mbështetës të:</p> <p>Aneks 1: Mendimi i Dekanit</p> <p>Aneks 2.1: Statuti i i UBT-së,</p> <p>Aneks 3.1: Plani strategjik i UBT 2016-2025</p>

<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>GVJ konfirmon se shqyrtimi i DVV dhe bazuar në vizitën në institucion për përputhjen e qëllimeve dhe misionit të programit Bachelor me ato të paraqitura në dokumentacionin e paraqitur prej UBT për këtë qëllim.</p> <p>Qëllimet dhe misioni i këtij programi studimi synon përgatitjen e specialistëve të fushës së bujqësisë dhe mjedisit.</p> <p>Fusha e veprimtarisë së institucionit në tërësi, UBT dhe FBM, si dhe DAME si njësi bazë që zbaton këtë program janë gjetur në përputhje të plotë. Ndër vite, UBT-ja dhe specifikisht FBM kanë formuar dhe kualifikuar specialistë të fushës së mjedisit dhe të bujqësisë, pyjeve dhe të burimeve natyrore.</p> <p>Gjatë takimeve me stafin në institucion është konfirmuar ndërlidhja dhe bashkëveprimi horizontal ndërmjet njësive të ndryshme në institucionin e UBT si në fushën e mësimdhënies (shkëmbimi i stafit pedagogjik ndërmjet njësive të ndryshme) dhe në atë të kërkimit shkencor.</p> <p>Dokumentacioni DVV i referuar edhe në RVB, i konfirmuar dhe gjatë vizitës në institucion:</p> <p>Aneks 2.1: Statuti i UBT</p> <p>Aneks 5.1: Rregullore e studimeve në UBT</p> <p>Aneks 7.1: Rregullore e studimeve në programin Bachelor Inxhinieri Agromjedisi</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>GVJ pohon se programi i studimeve Bachelor ofron dije në fushat e menaxhimit mjedisor dhe të bujqësisë. Ai është ndërtuar dhe strukturuar mbi bazën e përvojës shumë vjecare të institucionit, FBM dhe vecanërisht të Departamentit të Agromjedisit dhe të Ekologjisë, që synon përgatitjen e specialistëve bazë të cilët mund të vijojnë studimet në ciklin e dytë të studimeve apo të përthithen nga tregu i punës në nivel kombëtar në fushat e menaxhimit mjedisor, menaxhimit të fermave bujqësore dhe atë të të burimeve natyrore.</p> <p>Përvoja shumëvjecare e UBT dhe gati 20 vjecare e këtij Departamenti (prej vitit 2001) ka mundësuar të përmbushë nevojat e tregut kombëtar të punës me specialistë të fushës dhe ti përshtatet kërkesave të reja të këtij tregu.</p> <p>Numri i studentëve plotëson kuotat dhe kërkesa në rritje për vijimin e studimeve të nivelit të parë në këtë Program Bachelor, aktualisht me rreth 350 studentë në tre vitet e studimit, është tregues – i konfirmuar edhe gjatë vizitës në institucion dhe takimin me stafin dhe studentët - se tregu i punës paraqet kërkesë për profesionistë të fushave të tilla.</p> <p>Dokumentacioni mbështetës i shqyrtuar për këtë kriter përbëhet nga:</p> <p>Aneks 2.1: Statuti i UBT</p> <p>Aneks 7.1: Rregullore e studimeve në Programin Bachelor.</p> <p>Aneksi 14.1: Programi i studimeve në BSc Inxhinieri Agromjedisi</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">✓</p>

<b>Standardi I.2</b>	
<b>Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>Shqyrtimi i DVV dhe informacioni i grumbulluar nga vizita në institucion konfirmon ndjekjen e linjës së përcaktuar në nivel institucional të shprehur deri në objektivat e programit Bachelor Inxhinieri Agromjedisi.</p> <p>Qëllimet dhe misioni i këtij programi studimi është në koherencë me atë të institucionit në tërësi për përgatitjen e specialistëve të fushës së bujqësisë dhe mjedisit. Plani strategjik i UBT-së 2016-2025 thekson se ruhet dhe forcohet më tej fusha e veprimtarisë së institucionit në tërësi dhe në njësinë bazë që zbaton këtë program. Statuti i UBT-së dhe takimet me nivelet drejtuese të institucionit (Dekan i FBM dhe Përgjegjësin e DAME) konfirmojnë se përputhshmëria e veprimtarisë së programit me atë të institucionit në tërësi: formimi i specialistëve të fushës së menaxhimit të mjedisit në bujqësi dhe më gjerë, dhe atë të burimeve natyrore. UBT ka përvojë të gjatë dhe unike në menaxhimin e burimeve natyrore si ato të tokës, pyjeve, burimeve gjenetike të bimëve dhe kafshëve, etj.</p> <p>DVV, dokumentacioni mbështetës i paraqitur në RVB, i konfirmuar dhe gjatë vizitës në terren:</p> <p>Aneks 2.1: Statuti i UBT</p> <p>Aneks 3.1: Plani strategjik i UBTsë 2016-2025</p> <p>Aneks 14.1: Kurrikula e studimeve BSc Inxhinieri Agromjedisi</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Bazuar në DVV, GVJ pohon se dokumentet drejtuese të politikës së UBT-së (statuti dhe rregullorja) shërbejnë si bazë drejtimi edhe në ndërtimin dhe funksionimin e programit Bachelor Inxhinieri Agromjedisi. GVJ ka shqyrtuar kryesisht Planin strategjik të UBT 2016-2025, dhe rregulloren e institucionit.</p> <p>Drejtimit akademike të programit (prodhim bimor, mbrojtje bimësh, agromjedisi dhe ekologji, politika bujqësore, menaxhim mjedisor, zhvillim i integruar rural, etj) paraqesin përputhshmëri të programit me drejtimit akademike të njësisë bazë, por edhe të UBT-së në tërësi.</p> <p>Dokumentacioni i këtij programi (Rregullorja e programit dhe Plani mësimor) janë gjetur në zbatim dhe në përputhje me dokumentacionin bazë të institucionit të UBT-së.</p> <p>Aneks 2.1: Statuti i UBT</p> <p>Aneks 3.1: Plani strategjik i UBTsë 2016-2025</p> <p>Aneks 5.1: Rregullore e studimeve universitare</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.</p>	<p>GVJ konfirmon se programi i studimit të ciklit të parë Inxhinieri Agromjedisi synon përgatitjen e specialistëve në fushën e mjedisit me dije dhe kompetenca profesionale në përputhje me zhvillimet e sotme mjedisore, të jenë të aftë për të kontribuar në menaxhimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore në Shqipëri”.</p> <p>Emërtimi i programit është në përputhje me fokusin e institucionit (referencë “Bujqësia”) dhe të njësisë bazë (referencë Departamenti DAME). Ai është në përputhje me drejtimit akademike të institucionit</p>

	<p>dhe i përshkruan ato qartë në rregulloren e studimeve dhe në emërtimin e programit Inxhinieri Agromjedisi. Në përfundim të studimeve ai mundëson ofrimin e kompetencave të duhura në menaxhimin mjedisor dhe të bujqësisë.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar dhe verifikuar gjatë vizitës në terren:</p> <p>Aneks 2.1: Statuti i UBT</p> <p>Aneks 3.1: Plani strategjik i UBT 2016-2025</p> <p>Aneks 5.1: Rregullore e studimeve universitare në UBT</p> <p>Aneks 7.1: Rregullore e studimeve në programin Bachelor Inxhinieri Agromjedisi</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Plotësisht përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				✓

**Standardi I.3****Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>GVJ ka shqyrtuar DVV të paraqitur nga njësi bazë përgjegjëse për programin Bachelor Inxhinieri Agromjedisi. GVJ konfirmon deklaratën e RVB se programi ka objektiva të qarta për formimin e studentëve lidhur me fokusin e programit dhe llojin e formimit për specialistët e ardhshëm të fushës së menaxhimit mjedisor dhe të bujqësisë. Kurrikula e studimeve (Aneksi 14.1) paraqet kuadrin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të programit. Gjatë vizitës në institucion dhe diskutimi në stafin e DAME solli në vëmendjen e ekspertëve të GVJ objektivin kryesor të programit që ishte formimi i specialistëve në fushën e menaxhimit mjedisor, me fokus në burimet natyrore dhe bujqësinë. Ky drejtim kryesor konfirmon përputhjen e formimit të studentëve me profilin e programit. Shqyrtimi i sylabuseve të lëndëve ofron informacion shtesë mbi këtë përputhshmëri lidhur me dijet dhe aftësitë që synon të ofrojë ky program.</p> <p>Dokumentacioni i referuar në RVB dhe konfirmuar prej ekspertëve:</p> <p>Aneks 5.1: Rregullorja e UBT</p> <p>Aneks 6.1 Rregullorja e FBM 2017-2018</p> <p>Aneks 7.1: Rregullore e studimeve në programin bachelor Inxhinieri Agromjedisi</p> <p>Aneks 14.1: Kurrikula e studimeve ne BSc Inxhinjeri Mjedisi</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre,</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur prej institucionit dhe vizitës në terren u shqyrtua dhe vlerësua organizimi dhe shkalla e gjurmimit të studentëve të diplomuar të absorbuar në tregun e punës. UBT ka ngritur dhe ka funksionale Degën e Informimit, të Orientimit dhe të Karrierës së Studentëve e cila ka në varësi Qendrën e Karrierës dhe Alumnit (QKA) me specialistë të dedikuar për të ndjekur ecurinë e punësimit të studentëve pas përfundimit të studimeve.</p>



<p>mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Sikundërse referohet edhe në RVB, institucioni kryen një sërë veprimtarish me qëllim lidhjen e studentëve me tregun e punës dhe referimin në program të kërkesave të këtij tregu me qëllim lidhjen më të plotë të studentëve të diplomuar me mundësitë e punësimit.</p> <p>Institucioni organizon çdo vit Panairin e punës – në nivel universiteti, me pjesëmarrjen e kompanive dhe firmave të ndryshme. Studentët plotësojnë formularë interesi dhe kompanitë private pjesëmarrëse prezantojnë mundësitë e tyre të punësimit. Sipas referimit të stafit drejtues dhe QKA, në fushën e agro-mjedisit tregu i punës për studentët e diplomuar përbëhet nga institucione qendrore dhe vendore (njësitë përgjegjëse për menaxhimin mjedisor), kompanitë të ndryshme. Referohet se interesi i kompanive ka ardhur në rritje. QKA ndihmon studentët në plotësimin e dokumentacionit për punësim dhe pjesëmarrje në panaire të ndryshme.</p> <p>QKA ka gjurmuar studentët e diplomuar, por niveli i përgjigjeve të kthyer mbetet i ulët, që bën të vështirë një vlerësim të plotë dhe të saktë të segmenteve të tregut të punës të cilat përthithin studentët e diplomuar në Programin Bachelor Inxhinieri Agromjedisi. Përmirësimi i nivelit të gjurmueshmërisë duke rritur shkallën e informacionit të grumbulluar do të ndihmojë në lidhjen më të plotë me tregun e punës.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar dhe vlerësuar gjatë vizitës në institucion:</p> <p>Aneks 12.3: Vendim i Rektoratit për ZKS  Aneks 17.1: Studim i tregut të punës  Aneks 29.2: Raport i performancës së QKAsë  Aneks 37.2: Raport i QKA</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të nxënësve, garantojnë përfundimin e dijeve, aftësi, shkathësi dhe kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Shqyrtimi i DVV prej GVJ konfirmojnë se objektivat e programit mësimor Bachelor Inxhinieri Agromjedisi synojnë formimin e specialistëve të ardhshëm të menaxhimit të mjedisit në fushën e agromjedisit me dije dhe aftësi profesionale që i përgjigjen nevojave të tregut dhe tendencave të vendit dhe ato ndërkombëtare në këtë drejtim. Ato shprehen jo vetëm në dokumentat kryesore të programit (Rregullore e programit të studimeve) por edhe në Planin mësimor të programit.</p> <p>GVJ i referohet RVB dhe planit mësimor për të përcaktuar se 54% të disiplineve janë të formimit karakterizues duke ju mundësuar studentëve formimin e tyre si profesionistë të fushës së menaxhimit mjedisor dhe agromjedisit.</p> <p>Ndryshimet e referuara e ndodhura në program gjatë viteve 2013-2014 dhe 2017-2018, të konfirmuara edhe gjatë takimit me stafin pedagogjik të këtij programi mësimor kanë synuar të përafrojnë kërkesat e tregut të punës në dije të nevojshme në këtë fushë studimit duke përfshirë lëndë apo tematika të reja që mundësojnë punësimin e studentëve që pas përfundimit të programit Bachelor.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar dhe vlerësuar gjatë vizitës në institucion:</p>

	Aneksi 7.1: Rregullore e programit të studimit Inxhinieri Agromjedisi Aneksi 17.1: Studim periodik i tregut të punës Aneks 19: Syllabuse të lëndëve			
Shkalla e përbushjes së standardit	Përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				✓

**Standardi I.4**

**Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>Njësisia përgjegjëse për zbatimin e programit të studimit Bachelor Inxhinieri Agromjedisi është DAME. Përshkrimi në DVV, vizita në institucion dhe shqyrtimi i dokumentacionit të bollshëm japin një pamje të plotë të kapaciteteve dhe burimeve të institucionit për të ofruar dhe menaxhuar një program të tillë studimi. DAME, si Departament i Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit (FBM) është krijuar në vitin 2001, dhe ka në përbërje të tij një personel mësimor, shkencor dhe mbështetës të plotë për nevojat e këtij programi.</p> <p>Në përbërje të stafit të FBM janë 86 personel akademik (44 me titull të kategorisë Prof. dhe 21 Prof. As., 1 Docent, 1 Doktor, 10 Lektorë dhe 9 Asistent lektor). (Aneksi 23.4)</p> <p>Në përbërje të stafit të DAME janë 22 personel akademik (13 me titull të kategorisë Prof. dhe 2 Prof. As., 4 Lektorë dhe 3 Asistent lektor), dhe 10 punonjës mbështetës dhe administrativ.</p> <p>Shqyrtimi i CV të stafit akademik jep informacion se i tërë stafi akademik ka marrë pjesë në shkëmbime dhe kualifikime të gjata dhe shkurtra jashtë vendit (rreth 80% e stafit ka përfutur gjatë vitit 2018), më së shumti në universitete perëndimore dhe ka një numër të lartë botimesh shkencore (62 artikuj shkencorë dhe 58 referime/kumtesa shkencore) në revista brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Përbërja moshore e stafit akademik është e balancuar duke pasur grup-mosha të ndryshme që mundësojnë përcimin e përvojës dhe kualifikimit brenda njësisë.</p> <p>Përvoja 19 vjecare e DAME, ka mundësuar ri-orientimin dhe kualifikimin e stafit në drejtime të cilat përmbahen në program, kryesisht në fushat më të reja të menaxhimit mjedisor.</p> <p>Gjatë takimit me stafin pedagogjik, në vizitën në institucion, stafi ka referuar mbingarkesë mësimore për pothuajse të gjithë stafin akademik, prej numrit të shtuar të studentëve dhe përfshirjes në programe të tjera mësimore të ciklit të parë dhe të dytë. Mbingarkesa mësimore është përballuar nga burimet e vetë departamentit, duke realizuar ngarkesë mësimore deri në 400 orë (nga 140 të planifikuara për kategorinë Profesor), por ajo vlerësohet e menaxhueshme, brenda normave të përcaktuara nga MASR. Stafi vlerëson se ulja e numrit të studentëve në vitet e</p>

	<p>ardhshme do të mundësojë ndjekjen më të mirë të punës së studentëve.</p> <p>Shqyrtimi i dokumenteve të referuara përmban:</p> <p>Aneks 23 Organograma e FBM</p> <p>Aneksi 23.4: Personeli akademik i FBM_Burimet njerëzore</p> <p>Aneks 20: Cv të stafit akademik</p> <p>Aneks 25.2: Të dhëna mbi ngarkesën mësimore të stafit akademik</p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>GVJ pohon se bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur dhe referimi prej takimeve gjatë vizitës në Institucion konfirmojnë se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit: “Agromjedisi” janë në përputhje me drejtimin e njësisë kryesore qoftë në nivel Fakulteti të Bujqësisë dhe Mjedisit dhe atë të Departamentit DAME.</p> <p>Kjo përputhshmëri shprehet në rregulloret e njësisë bazë në zbatim të VKM 531 dt 11.9.2018. Ajo shprehet qartë në emërtimin e programit të studimit, i cili është në koherencë me atë të njësisë bazë DAME.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Dokumentacioni i referuar për shqyrtim:</p> <p>Aneks 6.1: Rregullore e brendshme e FBM</p> <p>Aneks 7.1: Rregullore e programit të studimit Inxhinieri Agromjedisi</p> <p>Aneks 14.1: Kurrikula e studimeve ne BSc Inxhinieri Agromjedisi</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				✓

### Standardi I.5

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>GVJ konfirmon se nga shqyrtimi i një sërë dokumentesh të paraqitura prej Institucionit lidhur me marrëdhëniet brenda-institucionale me njësi të tjera bazë, si dhe vizita në institucion (takimi me stafin akademik, përgjegjësin e departamentit DAME) konfirmoi se programi mësimor realizohet kryesisht me mbulimin e personelit akademik të vetë njësisë bazë (DAME) dhe personel akademik i FBM për lëndë më të përgjithshme.</p> <p>Për nevoja specifike të mësimdhënies, ndërveprimi me njësi të tjera brenda FBM është i shprehur në procesin mësimor për lëndë të vecanta. Gjatë takimit në stafin akademik, merrnin pjesë një numër pedagogësh të njësive të tjera që kontribonin në procesin mësimor/kërkimor të Programi Bachelor Inxhinieri Agromjedisi, sidomos të vitit të parë.</p> <p>Sic shprehet në RVB, dhe referohet në dokumentin e analizës vjetore të DAME, vlerësimi i performancës kryhet për të gjithë stafin që merr pjesë në realizimin e objektivave të këtij programi.</p>

	<p>Dokumentacioni i shqyrtuar:</p> <p>Aneks 6.1: Rregullore e brendshme e FBM</p> <p>Aneks 7.1: Rregullore e Programit të studimit Inxhinier Agromjedisi</p> <p>Aneks 38.2 dhe 38.4: Analizë vjetore e DAME dhe FBM</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.</p>	<p>Sic është referuar në RVB dhe në takimin e Dekanin e FBM dhe Përgjegjës të Departamentit DAME, njësia bazë ka një sërë bashkëpunimesh me institucionet kombëtare përfshirë këtu Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Agjenci të ndryshme shtetërore dhe një sërë kompanish private. Bashkëpunimi institucional është i shprehur dhe rregulluar kryesisht përmes Marrveshjeve të Bashkëpunimit ndërinstytucional me qëllim shkëmbimin e specialistëve dhe studentëve për qëllime të realizimit të procesit mësimor dhe kërkimit shkencor.</p> <p>Në dokumentacionin e paraqitur referohen shumë bashkëpunime brenda dhe jashtë vendit (19 kompani shqiptare) kryesisht në përmbushjen e detyrimit të praktikave profesionale të studentëve. Këto Marrveshje janë lidhur me Universitete homologe dhe subjekte private brenda vendit (referuar 49 Marrveshje bashkëpunimi me institucione akademike ndër vite prej viteve 2000).</p> <p>Sikundërse është referuar gjatë takimeve disa prej këtyre marrveshjeve rinovohen çdo vit në varësi të nevojës së institucionit dhe vlerësimi të bërë mbi ecurinë e zbatimit të Marrveshjes së Bashkëpunimit dhe diskutimit në analizën vjetore.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Dokumentacioni i shqyrtuar dhe konfirmuar gjatë takimeve në institucion:</p> <p>Aneksi 7.1: Rregullore e Programit të studimit Inxhinieri Agromjedisi</p> <p>Aneksi 34.2: Tabelë e bashkëpunimeve institucionale</p> <p>Aneksi 34.3: Tabelë e bashkëpunimeve të UBT me institucione akademike të huaja</p> <p>Aneksi 38.2 dhe 38.4: Analizë e punës së DAME dhe FBM</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Marrveshjet e bashkëpunimit të DAME kanë pasur në fokus zbatimin e praktikave profesionale. Këto bashkëpunime janë vlerësuar si nga studentët ashtu edhe nga stafi pedagogjik i DAME, gjatë vizitës në institucion, si një ndër komponente e rëndësishme e procesit mësimor. Ato kryhen në institucione apo kompani private mbi bazën e Marrveshjeve të Bashkëpunimit.</p> <p>Duke ju referuar DVV, institucioni referon Marrveshje Bashkëpunimi me institucione të fushës në nivel qendror si AKU, AKM, etj dhe institucione homologe akademike dhe institucione të tjera që punojnë në fushën e veprimtarisë.</p> <p>Vizitat si praktika mësimore në këto institucione drejtohen dhe monitorohen nga pedagogë të caktuar të DAME, të cilët janë kryesisht titullarë të lëndëve. Ato synojnë të krijojnë lidhje dhe aftësi praktike pune në institucione dhe kompani për të mundësuar punësimin e ardhshëm të studentët, duke u njohur me raste konkrete në prodhim/zbatim.</p> <p>Aneksi 34.2: Tabelë e bashkëpunimeve institucionale</p>

	Aneksi 34.3: Tabelë e bashkëpunimeve të UBT me institucione akademike të huaja			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Bazuar dhe referuar RVB, institucioni ofron një sërë kursesh kualifikimi si për Vlerësimin e Pasurive të Paluajshme, dhe Vlerësimin të Ndikimit në Mjedis, në të cilat studentët mund të vijojnë kualifikime pas përfundimit të studimeve në programin Bachelor, dhe të thellojnë njohuritë e tyre në fusha specifike. Megjithatë, GVJ nuk ka gjetur të dhëna specifike në DVV mbi numrin e studentëve që kanë përfunduar këtë program studimi, që kanë vijuar kualifikimin në kurset e mësipërme.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				✓

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				✓




## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

<b>Standardi II.1</b>	
<b>Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Si pjesë e DVV, Plani mësimor në ciklin e parë të studimeve jep një panoramë të lëndëve dhe module që zhvillohen në këtë program studimi. Bazuar në dokumentacionin e paraqitur lidhur me organizimin e programit të studimit, si dhe e konfirmuar gjatë vizitës në institucion, GVJ konfirmon se programi i Bachelor Inxhinieri Agromjedisi është i organizuar në lëndë dhe module. Çdo lëndë është e vlerësuar me kredite në bazë të ngarkesës në orë mësimore dhe orë pune individuale të studentit. Programi mësimor 2017-2018 përmban 180 kredite të ndarë në tre vite mësimore, me dy semestra në çdo vit, me ngarkesë prej 60 kreditesh në çdo vit mësimor (ose 30 kredite për çdo semestër).</p> <p>Përjashtime në këtë shpërndarje bëjnë viti I Sem I me 34 kredite kundrejt viti I Sem II me 26 kredite; dhe viti III Sem II me 32 kredite.</p> <p>Numri i krediteve është në përputhje me numrin e orëve mësimore në leksione apo detyrime të tjera gjatë viteve mësimore.</p> <p>Kjo mënyrë organizimi është në përputhje me VKM 41 dt 24.1.2018.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar:            Aneksi 5: Rregullorja e studimeve në UBT            Aneksi 6.1: Rregullorja e brendshme e FBM 2017-2018            Aneksi 7.1: Rregullorja e studimit në programin Inxhinieri Agromjedisi            Aneksi 14.1: Kurrikula e studimeve në BSc Inxhinieri Agromjedisi</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesioneve e specialitetesh.</p>	<p>Shqyrtimi i Programit të studimit dhe Kurrikulës së lëndëve, e diskutuar edhe në takimin me stafin e DAME dhe studentët e programit Bachelor, paraqet një larmishmëri lëndësh që mbulojnë fusha të përgjithshme të shkencave bazë si Matematikë, Fizikë, Kimi, Biologji, Botanike Bazat e ekonomisë, Bazat e prodhimit shtazor, Gjenetikë, Mikrobiologji, Ekologji, Fiziologji. Në Sem II të vitit të II futen edhe lëndë më specifike të formimit karakterizues si Topografi, Pesticidet, Teknologji kultivimi, të cilat në vitin e III zgjerohen më tej me Menaxhim ujrash, dhe Toke, Vlerësim dhe Auditim Mjedisor, Trajtimi i Tokës dhe mbetjeve, dhe disa lëndë me zgjedhje.</p> <p>Kjo mundëson mbulimin e fushave të ndryshme të specialiteteve të menaxhimit të mjedisit (Tokë, Ujra, Mbetje) duke krijuar mundësi punësimi në disa drejtime apo institucione.</p> <p>Gjatë takimeve edhe me drejtuesit e njësisë dhe pedagogët e lëndëve u shpreh qartë interesi për të pasur një mbulim sa më të gjerë, i cili arrihet përmes ndërtimit dhe përfshirjes së lëndëve të formimit karakterizues, por me aplikime konkrete në drejtime të ndryshme. Përfshirja e punëve laboratorike apo edhe vizitave në terren (praktika mësimore) studentët orientohen drejt një tregu të gjerë punësh.</p>

	<p>Ndër dokumentet e shqyrtuara më të rëndësishme për të vlerësuar këtë kriter është:</p> <p>Aneksi 14.1: Kurrikula e studimeve në BSc Inxhinjeri Agromjedisi</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuar në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>GVJ konfirmon bazuar në shqyrtimin e Planit mësimor 2017-2018 se Programi Bachelor Inxhinieri Agromjedisi përmban disa lëndë specifike të drejtimit të menaxhimit mjedisor në vitin III (Menaxhim Ujrash, Toke, Mbetjesh, Vlerësim dhe Auditim Mjedisor, Burimet e Energjisë Alternative, Teknologjitë e Mekanizimit). Studentët e takuar gjatë vizitës në institucion, si edhe pedagogët e lëndëve në këtë program konfirmuan se programi Bachelor Inxhinieri Agromjedisi është strukturuar në konceptin e zgjerimit të njohurive duke futur shtrirjen e njohurive mbi fusha të ndryshme të menaxhimit mjedisor dhe bujqësisë, duke rritur kështu gamën e kompetencave për zgjidhjen e problemeve shkencore dhe praktike. Një numër lëndësh me zgjedhje plotësojnë këtë formim dhe i japin programit një karakter dinamik dhe bashkëkohor. Sikundërse shprehet edhe RVB, por e konfirmuar edhe nga pedagogët e këtij programi studimi, përmirësimi dhe modifikimi i kurrikulës ndodh çdo vit, kryesisht duke futur koncepte dhe njohuri mbi praktika të reja e novatore.</p> <p>Ndër dokumentet e shqyrtuara më të rëndësishme për të vlerësuar këtë kriter është:</p> <p>Aneksi 14: Programet mësimore dhe Kurrikula e programit</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Sikurse përmendet edhe në vlerësimin lidhur me Kriterin 1 të këtij standardi, Programi i studimit të Bachelor Inxhinieri Agromjedisi është ndërtuar në përputhje me kërkesat ligjore të një programi studimi të ciklit të parë.</p> <p>GVJ konfirmon se për çdo lëndë apo modul, programi parashikon leksione për elementët teorike, seminare. Në vitin e dytë dhe të tretë shtohet numri i lëndëve që kanë detyra dhe projekte kursi (Viti I: 3 nga 14 lëndë; Viti II 6 nga 13 lëndë dhe Viti III 8 nga 12 lëndë). Programi i studimi ka të përshkruar dhe normuar mënyrën e vlerësimit dhe të kontrollit të dijeve (me shpërndarjen në % të vlerësimit për vlerësimin e vazhduar dhe atë përfundimtar me provim).</p> <p>Aneksi 5: Rregullorja e studimeve në UBT  Aneksi 6.1: Rregullorja e brendshme e FBM 2017-2018  Aneksi 7.1: Rregullorja e studimit në programin Inxhinieri Agromjedisi  Aneksi 14.1: Kurrikula e studimeve në BSc  Aneksi 14.2 Plani mësimor 2017-2018  Sylabuset e lëndëve  Aneksi 19.1: VKM 41 dt 24.1.2018</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>GVJ konfirmon se Programi Bachelor Inxhinieri Agromjedisi është i organizuar me lëndë të formimi bazë dhe ato karakterizuese, secila me ngarkesë të përcaktuar orësh në auditor (leksione) apo punë të pavarur (detyra kursi, projekte kursi, etj). Strukturimi i programit nga viti i parë deri në vitin e tretë kalon nga lëndët bazë drejt atyre karakterizuese me shpërndarje të drejtë në mes lëndëve të formimit bazë karakterizues dhe atyre integruese apo formuese (Shih më shumë shpjegimet në kriterin 2 dhe kriterin 3&amp;4)</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>GVJ konfirmon se Programi Bachelor Inxhinieri Agromjedisi është i organizuar me lëndë të formimi bazë dhe ato karakterizuese, secila me ngarkesë të përcaktuar orësh në auditor (leksione) apo punë të pavarur (detyra kursi, projekte kursi, etj). Strukturimi i programit nga viti i parë deri në vitin e tretë kalon nga lëndët bazë drejt atyre karakterizuese me shpërndarje të drejtë në mes lëndëve të formimit bazë karakterizues dhe atyre integruese apo formuese (Shih më shumë shpjegimet në kriterin 2 dhe kriterin 3&amp;4)</p>

Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				✓

**Standardi II.2**

**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush kërkesat ligjore për këto njësi.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>GVJ konfirmon se bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe verifikimin gjatë vizitës në institucion, Departamenti DAME, është njësia bazë përgjegjëse për zbatimin e programit të studimit. Ai është strukturë në përbërje të Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit.</p> <p>Ky institucion e ka kaluar procesin e akreditimit institucional sipas ligjit të Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë (2015). Detyrimet në nivelin e FBM kanë të bëjnë me hartimin e politikave dhe sigurimin e cilësisë, të cilat shprehen në Rregulloren e FBM 2017-2018.</p> <p>Njësia e sigurimit të cilësisë që vepron në nivel të UBT-së garanton cilësinë në procesin mësimor.</p> <p>Në bazë të dokumentacionit të paraqitur dhe shqyrtimit të tij gjatë vizitës në terren lidhur me funksionimin dhe veprimtarinë e saj, GVJ vërtetojnë se njësia bazë i plotëson kushtet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin e programit.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar: Aneksi 6.1: Rregullore e FBM 2017-2018 Aneksi 7.1: Rregullore e studimit në BSc Inxhinieri Agromjedisit</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e kordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>DVV përmban dokumentacionin e duhur lidhur me emërimin e kordinatorit të programit (Aneksi 36 të dokumentacionit të DVV) .</p> <p>Gjatë vizitës në institucion ekspertët e GVJ u takuan dhe u njohën me kordinatorin e programit, diskutuan për detyrat e tij që përfshijnë aspekte organizative dhe kordinuese të procesit mësimor dhe organizativ.</p> <p>Një pjesë e mirë e diskutimit është fokusuar në ecurinë e programit lidhur me aspektet organizative të ndarjes ngarkesës, konceptit të strukturës së programit, objektivat e programit të studimit, elementet e matjes së cilësisë dhe zbatimit të detyrimeve në nivelin e njësisë zbatuese.</p> <p>GVJ konfirmon angazhimin e plotë të DAME dhe të kordinatorit të programit për strukturimin dhe funksionimin sa më të mirë të këtij programi, në linjë me përcaktimet në rregulloret e institucionit dhe ndjekjen e tendencave të zhvillimit të vendit dhe tregut të punës.</p> <p>Aneks 36.1: Vendim për emërimin e kordinatorit të programit të studimit</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Dokumentacioni i paraqitur si në DVV dhe RVB shprehen se DAME si njësia bazë përbush detyrimet lidhur me zbatimin e përcaktimeve ligjore dhe rregulluese për një program të tillë studimi të ciklit të parë lidhur me aspektet organizative (personelin akademik, mjediset, sistemet funksionale të informimit dhe komunikimit, etj) dhe ato të përmbajtjes (ndërtimi i planit mësimor, kurrikulës, etj).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përbush detyrimet për numrin dhe</p>	



shkallën e kualifikimit të personelit akademik.	<p>Gjatë vizitës në institucion, Dekani i FBM dhe përgjegjësi i DAME kanë konfirmuar vlerësimin institucional të përmbushjes së detyrimeve të përcaktuara me ligj për organizimin e programit mësimor përfshirë dokumentacionin në nivel universiteti UBT, Fakulteti (FBM) dhe DAME. Dokumentacioni përmban statutin e universitetit, rregulloret e funksionit institucional dhe ato të lidhura me programin janë të hartuara dhe gjenden të afishuara në faqen e internetit të njësisë bazë.</p> <p>Aneksi 2.1 : Statuti i UBTsë  Aneksi 6.1: Rregullore e FBM 2017-2018  Aneksi 7.1: Rregullore studimi në programin Inxhinieri Agromjedisi GVJ ka vlerësuar përmbushjen e detyrimit institucional të FBM dhe DAME si strukturat përgjegjëse për zbatimin dhe mbarëvajtjen e programit të studimit. Njësia bazë përmbush edhe kriterin e angazhimit të stafit akademik dhe atij mbështetës.</p> <p>Stafi akademik i Programit të studimit Bachelor Inxhinieri Agromjedisi sigurohet nga DAME (njësia bazë) dhe FBM (Strukturë e të cilit është DAME. DAME, i krijuar në 2001 si departament i Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit (FBM), përbëhet nga një personel mësimor, shkencor dhe mbështetës të plotë për nevojat e këtij programi. Në përbërje të stafit janë 22 personel akademik (13 me titull të kategorisë Prof. dhe 2 Prof. As., 4 Dr dhe 3 MSc), dhe 10 punonjës mbështetës dhe administrativ.</p> <p>Stafi i angazhuar në këtë program përbëhet nga 22 personel akademik i brendshëm (13 Prof, 2 Prof As. 4 Dr dhe 3 MSc) dhe 12 të ftuar (4 Dr dhe 8 MSc.), me kontratë me kohë të plotë pune</p> <p>Një sërë lëndësh mbulohe nga staf i FBM, i cili ka në përbërje të tij 86 punonjës akademikë (nga të cilët (44 me titull të kategorisë Prof. dhe 21 Prof. As., 1 Docent, 1 Doktor, 10 Lektorë dhe 9 Asistent lektor). (Aneksi 23.4)</p> <p>Shqyrtimi i CV të stafit akademik të DAME jep informacion se i tërë stafi akademik ka kryer ose është në proces kualifikimi për marrjen e titujve dhe gradave si dhe ka marrë pjesë në shkëmbime dhe kualifikime të gjata dhe shkurtra jashtë vendit. Personeli përbëhet nga staf me kohë të plotë.</p> <p>Aneksi 14.1: Kurrikula e studimeve në BCs  Aneksi 20: CV të stafit akademik</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

**Standardi II.3**

**Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.**

**Kriteret****Vlerësimi i ekspertëve**



<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Sikundërse referohet në DVV dhe RVB, GVJ ka vlerësuar gjatë takimeve në institucionin procesi i vlerësimit të ecurisë së punës është vjetor dhe kryhet prej Përgjegjësit të Departamentit DAME për të gjitha aspektet e performancës në procesin mësimor dhe organizimin praktik të punës së lidhur me programin.</p> <p>Dokumentacioni i paraqitur (DVV) dhe verifikimi në institucion mundësojnë GVJ të konfirmojë se DAME si njësi bazë përmbush detyrimet lidhur me disponimin e materialeve dhe të dokumentacionit për programin e studimit të ciklit të parë Inxhinieri Agromjedisi.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, Dekani i FBM dhe përgjegjësi i DAME kanë konfirmuar vlerësimin institucional të përmbushjes së detyrimeve të përcaktuara me ligj për organizimin e programit mësimor përfshirë dokumentacionin në nivel universiteti UBT, Fakulteti (FBM) dhe DAME.</p> <p>Dokumentacioni përmban statutin e universitetit, rregulloret e funksionit institucional dhe ato të lidhura me programin janë të hartuara dhe gjenden të afishuara në faqen e internetit të njësisë bazë.</p> <p>Aneksi 2.1 : Statuti i UBTsë Aneksi 6.1: Rregullore e brendshme e FBM 2017-2018 Aneksi 7.1: Rregullore studimi në programin Bachelor Inxhinieri Agromjedisi</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur lidhur me organizimin e programit të studimit, si dhe e konfirmuar gjatë vizitës në institucion, programi i studimit Inxhinieri Agromjedisi është i organizuar në lëndë dhe module.</p> <p>Programi Bachelor Inxhinieri Agromjedisi përmban disa lëndë, të cilat vlerësohen të jenë formuese për specialistin e ardhshëm të fushës së menaxhimit bujqësor dhe mjedisor. GVJ konfirmon se Programi Bachelor Inxhinieri Agromjedisi është i organizuar me lëndë të formimit bazë dhe ato karakterizuese, secila me ngarkesë të përcaktuar orësh në auditor (leksione) apo punë të pavarur (detyra kursi, projekte kursi, etj). Strukturimi i programit nga viti i parë deri në vitin e tretë kalon nga lëndët bazë drejt atyre karakterizuese me shpërndarje të drejtë në mes lëndëve të formimit bazë karakterizues dhe atyre integruese apo formuese</p> <p>Një numër lëndësh me zgjedhje (Viti III Sem. II) plotësojnë këtë formim dhe i japin programit një karakter dinamik dhe bashkëkohor.</p> <p>Aneks 14.1: Kurrikula e studimit në BSc Inxhinieri Agromjedisi Aneks 14.3: Plani Mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Çdo lëndë është e vlerësuar me kredite në bazë të ngarkesës në orë mësimore dhe orë pune individuale të studentit. Programi mësimor 30 javë mësimor/vit akademik; përmban 180 kredite të ndarë në tre vite mësimore, me dy semestra në çdo vit, me ngarkesë prej 60 kreditesh në çdo vit mësimor.</p> <p>Programi mësimor 2017-2018 përmban 182 kredite të ndarë në tre vite mësimore, me dy semestra në çdo vit, me ngarkesë prej 60 kreditesh në çdo vit mësimor (ose 30 kredite për çdo semestër).</p>




	<p>Përrjashtime në këtë shpërndarje bëjnë viti I Sem I me 34 kredite kundrejt viti I Sem II me 26 kredite; dhe viti III Sem II me 32 kredite.</p> <p>Numri i krediteve është në përputhje me numrin e orëve mësimore në leksione apo detyrime të tjera gjatë viteve mësimore.</p> <p>Kjo mënyrë organizimi është në përputhje me VKM 41 dt 24.1.2018.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar:  Aneksi 6: Rregullorja e brendshme e FBM 2017-2018  Aneksi 7.1: Rregullorja e programit të studimit Inxhinieri Mjedis  Aneksi 14.1: Kurrikula e studimeve në BSc  Aneksi 14.2: Plani mësimor 2017-2018</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Shqyrtimi i Dosjes së plotë të programit që përmban Planin mësimor dhe Kurrikulën e plotë me sylabuset e lëndëve përmban të gjithë informacionin e nevojshëm të përcaktuar sipas ligjit lidhur me:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Lëndët sipas viteve dhe çdo semestër me kreditet përkatëse</li> <li>Ngarkesën e orëve në auditor si leksione, seminare dhe laboratore</li> <li>Praktikat mësimore dhe / ose profesionale, në varësi të lëndëve apo semestrit të përcaktuar në planin mësimor</li> <li>Mënyrën e vlerësimit të çdo lëndë: provim dhe mënyrës së realizimit të tij, vlerësim i vazhduar etj.</li> </ol> <p>Bazuar në takimet me stafin dhe studentët ë këtij programi gjatë vizitës në institucion është marrë informacioni se studenti njihet me programin dhe mënyrën e vlerësimit përmes dokumentacionit të afishuar në faqen e internetit, njohjes së tij në fillim të vitit prej pedagogëve të lëndëve apo edhe përmes sekretarisë mësimore.</p> <p>Dokumentacioni lidhur me këtë kriter vlerësohet i plotë dhe i mjaftueshëm për studentin Ky fakt është konfirmuar edhe prej studentëve të takuar, të cilët kanë vlerësuar pa probleme këtë pjesë të njohjes së programit të ofruar nga institucioni.</p> <p>Vlerësimi i studentëve bazohet në vlerësimin e vazhduar (Detyra kursi e projekte) dhe atë në provim. Nga diskutimi me stafin akademik gjatë vizitës në institucion u shpreh tendenca është rritja e peshës së vlerësimit gjatë procesit mësimor që varion nga 30%-40%. Për të siguruar një nivel më të lartë të përfshirjes së studentëve dhe cilësi më të mirë, stafi akademik ka vënë në dukje tendencën e rritjes së mëtejshme të kësaj peshe drejt 50%.</p> <p>Aneksi 7.1: Rregullore studimi në programin Bachelor Inxhinieri Agromjedis  Aneksi 14.1: Kurrikula e studimeve në BSc</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>GVJ konfirmon se kriteret e pranimit në programin e studimit paraqiten në Rregulloren e studimeve të programit Bachelor Inxhinieri Agromjedis si edhe atë të FBM. Programet dhe rregulloret janë të publikuara në faqen e internetit.</p> <p>Gjatë procesit të verifikimit në institucion janë vërejtur raste të transferimit të studentëve ndërmjet programeve të ndryshme Bachelor, me kërkesën dhe interesin e vetë studentëve, në vitin e dytë. Kjo është e</p>




	<p>mundur për shkak se tre programet Bachelor në FBM kryejnë trung të përbashkët lëndësh në vitin e I, që mundëson këtë transferim (dhe ekuivalentin të plotë të studimeve të vitit I). Transferimi kryhet me kërkesën e studentit dhe është i mundur pas shqyrtimit në njësinë bazë vetëm nëse në Programin Inxhinieri Agromjedisi ka kuota të lira.</p> <p>Aneks 5.1: Rregullorja e studimeve në UBT  Aneks 6.1: Rregullorja e studimeve në FBM 2017-2018  Aneks 7.1: Rregullore e studimit në programin Inxhinieri Agromjedisi  Aneks 26.1: Të dhëna tabelore mbi programet në ciklin I-II</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Dokumentacioni i paraqitur për këtë program studimi (DVV) përmban në mënyrë të detajuar të gjithë sylabuset e lëndëve në Shqip dhe Anglisht, për të gjithë elementët mësimorë të programit.</p> <p>Standarti i miratuar është ai i të gjithë UBT-së me të gjithë elementët përshkrues të lëndës, pedagogut titullar, vitin dhe semestrin, informacioni i detajuar i përmbajtjes së lëndës, literaturës bazë dhe ndihmëse (në shqip dhe gjuhë të huaj), rezultatet e të nxënësve, konceptet bazë, etj.</p> <p>Dosja e programit është e plotë dhe përmban të gjithë sylabuset e lëndëve të programit. Formati i sylabuseve është i standartizuar në nivel universiteti (në nivel të UBT-së)</p> <p>Të gjitha sylabuset hartohen nga titullari i lëndës paraqiten çdo vit, pas kalimit të procesit të rishikimit (nëse ka të tillë) dhe miratohen nga titullari i njësisë bazë.</p> <p>Programi i studimit mund të ofrohet studentëve në formë të shtypur, bazuar në kërkesën e tyre në sekretarinë e UBT-së.</p> <p>Informacioni i shqyrtuar dhe diskutuar në vizitën në institucion gjendet në:</p> <p>Aneks 14.1: Kurrikula e studimeve  Aneks 14.2: Plani mësimor 2018-2019</p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Sikundërse shprehet edhe RVB, por e konfirmuar prej GVJ nga diskutimi me pedagogët e këtij programi studimi, përmirësimi dhe modifikimi i kurrikulës ndodh çdo vit, kryesisht duke futur koncepte dhe njohuri mbi praktika të reja e novatore. Ai kryhet mbi bazën e vlerësimit të ecurisë së programit.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, stafi pedagogjik i programit ka konfirmuar mënyrën e diskutimit të sylabuseve dhe programit të çdo lënde për të shmangur përsëritjet e informacionit në lëndë të ndryshme.</p> <p>Programet gjenden të arkivuara dhe në faqen e internetit në dy gjuhë: Shqip dhe Anglisht</p> <p>Aneks 14.1: Kurrikula e studimeve në BSC  Sylabuset e lëndëve</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">✓</p>

### Standardi II.4

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)




**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>GVJ konfirmon se nga shqyrtimi i DVV (Dosja e plotë të programit) për Programin e studimit Bachelor Inxhinieri Agromjedisit është i strukturuar me një ngarkesë sipas normimit juridik të përcaktuar. Ai përmban 180 kredite të shtrira në tre vite mësimore, me dy semestra në çdo vit, me ngarkesë prej 60 kreditesh në çdo vit mësimor (ose afërsisht 30 kredite për çdo semestër).</p> <p>Aneksi 5.1: Rregullorja e studimeve universitare Aneksi 7.1: Rregullorja e programit të studimit Inxhinieri Agromjedisit Aneks 14.1: Kurrikula e studimeve në BSc Aneksi 14.2: Plani mësimor 2018-2019</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.</p>	<p>GVJ shprehet se bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe njohjen e zbatueshmërisë së tij gjatë vizitës në institucion, sikundërse shprehet edhe në RVB, programi i studimi në ciklin e parë të studimeve Bachelor përmban lëndë të emërtuara dhe kategorizuara në lidhje me emërtimin e të gjithë programit. Lëndët synojnë të ofrojnë njohuri dhe aftësi për të krijuar studentëve mundësinë për studime të tjera më të thelluara në ciklin e dytë.</p> <p>Praktikat mësimore dhe lëndët zgjerojnë mundësinë e përfshirjes së studentëve në punësim në institucione dhe kompani private të ndryshme me fokus të gjerë.</p> <p>Aneks 14.1: Kurrikula e studimeve në BSc Aneksi 14.2: Plani mësimor 2018-2019</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.</p>	<p>Bazuar në informacionin e dhënë në RVB, dokumentacionin e depozituar për programin mësimor (DVV), shpërndarja e lëndëve gjatë viteve mësimore dhe në secilin prej 6 semestrave synon thellimin e njohurive në fusha specifike.</p> <p>Lëndët në Viti II Semestri II dhe ato të vitit të III-të janë specifike dhe formojnë specialist të përgjithshëm të fushës së bujqësisë dhe mjedisit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Shpërndarja është e balancuar dhe kalon natyrshëm nga lëndët formuese në ato më specifike që ndihmon studentin të formëzohet si specialist i ardhshëm.</p> <p>Lëndët përmbajnë orët teorike në auditor dhe ato praktike në laborator ose në praktikat mësimore. Në varësi të ngarkesës mësimore në çdo lëndë ndryshon edhe shpërndarja e orëve teorike dhe praktike. Kjo ngarkesë është e balancuar ndërmjet leksioneve (aspekteve teorike) dhe Seminare/Ushtrime (aspekte praktike) nga 50%-50% në 67% - 33%.</p> <p>Vlerësimi vjetor, i konfirmuar edhe gjatë vizitës në institucion ka synuar përmirësimin e vazhdueshëm të raportit dhe shpërndarjes ndërmjet lëndëve apo teorisë dhe praktikës.</p> <p>Aneks 7.1: Rregullore e studimeve në programin e studimeve Inxhinieri Agromjedisit</p>

	<p>Aneks 14: Kurrikula e studimeve në BSc</p> <p>Aneksi 38.2: Analizë vjetore e departamentit përgjegjës</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>GVJ ka shqyrtuar Planin mësimor të paraqitur në DVV dhe vlerëson 54% të kurrikulës e përbërë prej disiplinave karakterizuese që synojnë në formimin e specialistit të ardhshëm në fushën e bujqësisë dhe mjedisit. Vizita në institucion dhe diskutimi me stafin e DAME dhe zyrën e Karrierës dhe Alumni, konfirmojnë mundësinë dhe lehtësimin në transferimin e studentëve në/nga programe të tjera studimi.</p> <p>Për më tej, studentët janë të punësuar në një gamë të gjerë institucionesh qendrore dhe vendore dhe kompani private. Zyra e Karrierës konfirmon se nga kompanitë private që kanë marrë pjesë në Panairin e punës nuk kanë pasur kërkesa specifike lidhur me formimin specifik të studentëve në këtë program, ndonëse në anën tjetër është theksuar se punësimi i studentëve të porsa diplomuar është kryesisht në pozicione pune jo shumë të kualifikuar.</p> <p>Aneks 14.1: Kurrikula e studimeve në BSc</p> <p>Aneksi 27.9: Tabelë me të dhëna e studentëve të ardhur me transferim</p> <p>Aneksi 38.1 dhe 38.4: Analizë e punës vjetore të DAME dhe FBM</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Në RVB dhe gjatë vizitës në institucion janë referuar dy periudha të rishikimit më të plotë të kurrikulës, ndërkohë që rishikimi është referuar nga përgjegjësit e njësive bazë dhe të FBM si proces i vazhdueshëm vjetor.</p> <p>Dy periudhat e referuara në RVB dhe prej stafit përgjegjës ku ndryshimet kanë qenë më substanciale janë 2013-2014 dhe 2017-2018. Ndryshimet kanë konsistuar në futjen e kapitujve të rinj, ri-emërtim dhe ndryshim lëndësh në varësi edhe të tendencave më të fundit në lëndë të ndryshme.</p> <p>Aneks 14.1: Kurrikula e studimeve në BSc</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Bazuar në shqyrtimin e dosjes së plotë të studimeve (Aneks 14.1) GVJ konfirmon se tërësia e programit mësimor, kurrikulës dhe sylabuseve specifike të çdo lënde mundësojnë që në fund të studimeve dhe pas përmbushjes së detyrimeve të përcaktuara për studentin, ai të ketë mundur të përmbushë objektivat studimore dhe kërkimore shkencore të këtij programi studimi.</p> <p>Në fund të studimeve, studenti i diplomuar përmbush kriteret e vlerësimit si specialist në fushën e menaxhimit në bujqësi dhe të mjedisit, me aftësi dhe kompetencë profesionale për të adresuar çështje praktike dhe të detyrave institucionale në vendin e punës.</p> <p>Aneks 7.1: Rregullore e programit të studimit</p> <p>Aneks 19: Sylabuset e lëndëve</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe njohjen e zbatueshmërisë së tij gjatë vizitës në institucion, sikundërse shprehet edhe në RVB; Programi i studimit në ciklin e parë të studimeve Inxhinieri Agromjedijsi përmban lëndë të emërtuara dhe kategorizuara për të krijuar studentëve mundësinë për studime të tjera më të thelluara në ciklin e dytë në programe të ndryshme masteri.</p>

<p><b>Kriteri 9.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Për më tej, studentët janë të punësuar në një gamë të gjerë institucionesh qendrore dhe vendore dhe kompani private. Zyra e Karrierës konfirmon se nga kompanitë private që kanë marrë pjesë në Panairin e punës nuk ka pasur kërkesa specifike lidhur me formimin specifik të studentëve në këtë program, ndonëse në anën tjetër është theksuar se punësimi i studentëve të porsa diplomuar është kryesisht në pozicione pune jo shumë të kualifikuar.</p> <p>Aneksi 17.1: Studimi i tregut të punës</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				✓

### Standardi II.5

**Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>GVJ konfirmon se njësia bazë DAME ka kapacitetet e nevojshme të personelit akademik dhe ndihmësmësimitor për zbatimin e programit të studimit Inxhinieri Agromjedisi.</p> <p>Në përbërje të stafit të FBM janë 86 personel akademik (44 me titull të kategorisë Prof. dhe 21 Prof. As., 1 Docent, 1 Doktor, 10 Lektorë dhe 9 Asistent lektor), të punësuar me kohë të plotë. (Aneksi 23.4)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Në përbërje të stafit të DAME janë 22 personel akademik (13 me titull të kategorisë Prof. dhe 2 Prof. As., 4 Lektorë dhe 3 Asistent lektor), dhe 10 punonjës mbështetës dhe administrativ, të punësuar me kohë të plotë, të cilët kontribuojnë në realizimin e programit të këtij cikli studimi.</p> <p>Shqyrtimi i CV të stafit akademik jep informacion se i tërë stafi akademik ka marrë pjesë në shkëmbime dhe kualifikime të gjata dhe shkurtra jashtë vendit (rreth 80% e stafit ka përfutuar gjatë vitit 2018), më së shumti në universitete perëndimore dhe ka një numër të lartë botimesh shkencore (62 artikuj shkencorë dhe 58 referime/kumtesa shkencore) në revista brenda dhe jashtë vendit. Shqyrtimi i CV të stafit akademik jep informacion se i tërë stafi akademik ka kryer ose është në proces kualifikimi për marrjen e titujve dhe gradave si dhe ka marrë pjesë në shkëmbime dhe kualifikime të gjata dhe shkurtra jashtë vendit. Personeli përbëhet nga staf me kohë të plotë.</p> <p>Stafi akademik është i angazhuar edhe në programe të tjera studimi, qoftë të ciklit të parë (programe paralele Bachelor në FBM) apo te ciklit të dytë (programet Master Shkencor) të ofruara nga institucioni dhe vlerësohet i mbingarkuar me deri në 401 orë në vit. Të gjithë (përveç një punonjësi, janë të përfshirë me ngarkesë më të madhe se norma. Personeli me tituj ka deri ne 400 orë (nga 140 të përcaktuar si normë). Mbingarkesa është referuar në takimet me stafin si një problem i adresuar.</p> <p>Gjatë takimit me stafin akademik të përfshirë në këtë program studimi u theksua se zvogëlimi i numrit të studentëve ne cikle të ndryshme dhe</p>

	<p>përfshirja e doktorantëve të nivelit të tretë të studimit do të ndihmojë në zvogëlimin e mbingarkesës së pedagogëve të tjerë në programin mësimor. GVJ konfirmon se gjatë vizitës në institucion në Zyrën e Burimeve Njerëzore ka një procedurë të qartë dhe përcaktuar të punësimit të stafit të ri sipas kërkesave të përgjithshme dhe specifike të përcaktuara në nivelin e Departamentit. Stafi i punësuar në tre vitet e fundit kanë përfunduar studime pranë këtij Departamenti dhe në universitete jashtë vendit. Personeli akademik ka në dosjen e personelit dokumentacionin e plotë të kualifikimeve të marra ndër vite.</p> <p>Aneks 11: Rregullore e Zyrës së Burimeve Njerëzore Aneks 24.1: Të dhëna për stafin akademik në programin mësimor</p>				
<p><b>Kriteri 3.</b> Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>GVJ konfirmon se grupet kërkimore në kuadër të DAME, të cilat janë edhe kontribuesit kryesorë në zbatimin e programit të studimit në Inxhinieri Agromjedisori kanë profilizimin shkencor në fushat ku mbulojnë kërkimin shkencor dhe janë titullarë të lëndëve të programit mësimor. Gjatë vizitës në institucion, Përgjegjësi i DAME konfirmon informacionin e vendosur në sylabuset e lëndëve se titullaret e lëndëve janë të kategorisë Profesor dhe Lektorë të gradës Doktor (19 prej 22 punonjësve akademikë në këtë njësi bazë).</p> <p>Aneks 7: Rregullore e programit të studimit Aneks 11: Rregullore e Zyrës së Burimeve Njerëzore Aneks 20: CV të personelit akademik Aneks 24.1: Të dhëna për stafin akademik në programin mësimor</p>				
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konfirmon informacionin e dhënë në RVB dhe dokumentacionin e depozituar (DVV) mbi marrëveshjet e lidhura me institucione të ndryshme të nivelit qendror si AKU, AKM dhe 19 kompani private, me qëllim kryerjen e praktikës profesionale në semestrin 6-të të studimeve (5 kredite). Vizitat njohëse kryhen në institucione apo kompani private mbi bazën e Marrëveshjeve të Bashkëpunimit. Përgjegjësi i DAME përcakton pedagogët përgjegjës për ndjekjen e studentëve në zbatimin e praktikës profesionale. Pedagogu përgjegjës ndjek zbatimin e praktikës profesionale. Futja në bashkëveprim me një institucion/kompani formalizohet mbi bazën e marrëveshjeve standard.</p> <p>Aneksi 34.2: Tabelë e bashkëpunimeve institucionale Aneks 53.2: Praktikë mësimore në terren_DAME</p>				
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ ka konfirmuar me përgjegjësin e njësisë bazë numrin e personelit mbështetës dhe administrativ (ndihmës mësimor dhe shkencor), i cili përbëhet nga 10 vetë (31% e gjithë personelit të DAME), kryesisht përgjegjës për laboratorët në strukturën e njësisë bazë. Personeli ndihmës ndihmon në procesin mësimor kryesisht orët laboratorike të studentëve.</p> <p>Anneks 22.4: Lista e personelit akademik ndihmës në programin e studimit</p>				
	<table border="1"> <tr> <td data-bbox="592 1912 746 1973">Niveli</td> <td data-bbox="751 1912 906 1973">Përbushet pjesërisht</td> <td data-bbox="911 1912 1066 1973">Përbushet kryesisht</td> <td data-bbox="1070 1912 1418 1973">Përbushet plotësisht</td> </tr> </table>	Niveli	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
Niveli	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht		



<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>				✓
--	--	--	--	---

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>Niveli i përmbushjes</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				✓




### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV, rezulton se institucioni ka hartuar një sërë rregulloresh për nxitjen e përdorimit të metodave novatore në mësimdhënie përfshirë lëndët dhe modulet gjatë gjithë ciklit akademik. Prej 2010 është hartuar Udhëzuesi për krijimin e faqeve personale për të menaxhuar informacionin didaktik për studentët nëpërmjet Google Site. Prej 2016, në nivel të UBTsë përcillet një plan masash për zbatim në të gjitha njësitë.</p> <p>Aneksi 4.3: Plani i masave për mirëfillimin dhe mirë vijimin e vitit akademik Aneks 39.1: Udhëzues për përdorimin e metodave inovative Aneks 47: Udhëzues të ndryshëm lidhur me faqen e internetit dhe manuale rregjistrimi</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>GVJ konfirmon se në kuadër të analizës vjetore të punës së DAME dhe përmes pyetësorëve me studentët të organizuar në nivel UBT (prej Sektorit të Zhvillimit të Kurrikulave dhe Vlerësimit Institucional, vlerësohet në mënyrë të rregullt, vjetore, niveli dhe aftësitë mësimdhënëse të personelit akademik të këtij programi studimi.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ është informuar mbi procedurën e ndjekur prej këtij sektori dhe mbi shkallën e performancës për çdo lëndë në këtë program. Të dhënat e vlerësimit vihen në dispozicion të përgjegjësit të DAME për tu diskutuar më pas me secilin personel akademik.</p> <p>Aneksi 5.1: Rregullore e studimeve universitare Aneksi 6.1: Rregullore e brendshme e FBM Aneksi 37.1: Manual i cilësisë në UBT 2018</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>GVJ konfirmon se Sektori i Zhvillimit të Kurrikulave dhe Vlerësimit Institucional, vlerëson në mënyrë të rregullt, në periudha vjetore, përmes përfshirjes së studentëve në anë të një pyetësori.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ është informuar mbi procedurën e ndjekur prej këtij sektori dhe mbi shkallën e performancës për çdo lëndë në këtë program.</p> <p>Pyetësori plotësohet në përfundim të programit të leksioneve , përpara testimin të njohurive. Ai menaxhohet nga personel jashtë DAME, është anonim dhe plotësohet në format të shtypur. Ndonëse është refuar edhe një pyetësor on-line, ka pasur paqartësi lidhur me një pyetësor on-line prej studentëve, të cilët kanë referuar se parapëlqejnë versionin e shtypur. Takimi me studentët në institucion konfirmoi rëndësinë e një vlerësimi të tillë, meqënëse studentët janë shprehur se ndjehen të lirshëm në</p>

	<p>vlerësimin e tyre dhe SZKV ka konfirmuar grumbullimin e informacionit të vlefshëm prej studentëve lidhur me cilësinë dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor në tërësi.</p> <p>Aneksi 5.1: Rregullore e studimeve universitare Aneksi 6.1: Rregullore e brendshme e FBM Aneksi 37.1: Manual i cilësisë në UBT 2018 Aneksi 40.1: Pyetësor i studentëve dhe analiza e anketimit</p>			
<b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	<p>GVJ ka shqyrtuar dokumentacionin dhe ka konfirmuar gjatë vizitës në institucion se institucioni ka hartuar dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë. Raporti vjetor i monitorimit analizon cilësinë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor të realizuar në të gjitha njësitë bazë. Raporti i hartuar në nivel departamenti (DAME), shpërndahen dhe diskutohen në njësinë bazë për përmirësimin e punës në të vitin e ardhshëm akademik. Në RVB referohet se nga viti i ardhshëm akademik 2019-2020, rezultatet e këtij vlerësimi do të vendosen edhe on-line.</p> <p>Nxitja e stafit akademik për zbatimin e praktikave të mira referohet të jetë kryer përmes bërjes publike të rezultateve të anketimit të studentëve dhe përmes rrugëve të tjera si organizimi i leksioneve të hapura për stafin akademik dhe studentët në programin e studimit.</p> <p>Aneksi 38. Analizë e Departamentit përgjegjës (vjetore/periodike) mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.</p>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies.				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Plotësisht përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			✓	

<b>Standardi III.2</b>	
<b>Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	<p>GVJ konfirmon se DAME dhe personeli akademik i përfshirë në zbatimin e programit të studimit përdor një gamë të gjerë formash të mësimdhënies: leksionet, seminarët, laboratorët, praktikat mësimore dhe profesionale.</p> <p>Gjatë takimit me stafin akademik dhe kordinatorin e programit të studimit u paraqit se vemëndje e veçantë i kushtohet pjesës praktike (kryesisht punës në laborator) për të rritur aftësitë praktike të studentëve.</p> <p>Meqënëse numri i studentëve në këtë program studimi të ciklit të parë është relativisht i madh, aktivizimi i tyre bëhet mesë shumti përmes detyrave të kursit.</p> <p>Aneks 14: Kurrikula e studimit në BSc</p>

<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>Stafi akademik ka konfirmuar në takimet gjatë vizitës në institucion se përpiqet të adresojë nevojat e veçanta të studentëve, përfshirë edhe interesat e tyre specifike për avancim në fusha të caktuara të kërkimit. Një rrugë tjetër e paraqitur në takimet me stafin, referuar edhe në RVB është organizimi i punës në grupe të vogla studentësh për detyra kursi apo prezantime të ndryshme. GVJ referon se stafi akademik ka paraqitur edhe vizitat studimore një ditore në institucione të ndryshme, ferma bujqësore, impjante prodhimi, etj.</p> <p>Aneks 19.1: Sylabuset e lëndëve</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Institucioni ka hartuar udhëzues për personelin akademik që të zhvillojë aftësitë e veta lidhur me përdorimin e teknologjive të reja të komunikimit përmes udhëzuesve të hartuar (2010). Mundësia e përdorur më shpesh është përfshirja në Marrveshjet e Bashkëpunimit me institucionet homologe jashtë vendit, ku një numër i madh anëtarësh të personelit akademik (80% e stafit) kanë përfituar mobilitete dhe kanë marrë pjesë në aktivitete shkëmbimi. Në 49 marrveshjet e bashkëpunimit (ndër vite), stafi i DAME ka përfituar në të gjitha ato programe ku fusha e veprimtarisë përputhet me aktivitetet e parashikuara në këto Marrveshje. Gjatë vitit akademik 2017-2018, RVB pohon se 80% e stafit akademik ka lëvizur jashtë vendit me programe shkëmbimi ose pjesëmarrje në aktivitete shkencore (konferenca, takime, etj). Zyrat e Sekretarisë dhe ajo e Karrierës dhe Alumni informojnë mundësitë e shkëmbimit, përmbajtjen e lëndëve dhe moduleve apo veprimtarive formuese. Gjithashtu studentët informohen edhe nëpërmjet sistemit të brendshëm të menaxhimit të informacionit apo faqeve personale të pedagogëve në internet.</p> <p>Aneksi 4: Plani i masave të UBTsë Aneksi 38: Raporti analizës vjetore të DAME</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Bazuar në kualifikimet e marra prej stafit akademik dhe në rezultatet e grumbulluara prej pyetësoreve me studentët, GVJ vlerëson se stafi akademik është në nivelin e duhur të kompetencës për tu përfshirë në procesin e mësimdhënies.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Titullarët e lëndëve janë me titull Profesor. Stafi i angazhuar në këte program perbehet nga 22 personel akademik i brendshëm ( 13 Prof, 2 Prof As. 4 Dr dhe 3 MSc) dhe 12 te ftuar (4 Dr dhe 8 MSc.)</li> <li>- CV e stafit përmbajnë kualifikime të mjaftueshme për përfshirjen në mësimdhënie</li> <li>- Stafi DAME mbetet i angazhuar në procesin e kërkimit shkencor me rreth 54 artikuj shkencorë të botuar brenda dhe jashtë vendit, 14 prej të cilëve me faktor impakti</li> </ul> <p>Procesi i rekrutimit të stafit të ri, përmes kriterëve specifike të rekrutimit, garanton cilësinë në mësimdhënie. Gjatë takimit në zyrën e Burimeve Njerëzore dhe Pagave, u sugjerua përfshirja në procesin e vlerësimit edhe e aftësive prezantuese dhe</p>

	argumentuese të aplikantëve kandidatë për staf akademik, të cilët planifikohen të jenë pjesë e stafit mësimdhënës në këtë program studimi. Aneksi 6.1: Rregullore e brendshme e FBM Aneksi 11.1: Rregullore e ZBNjP Aneksi 14.1: Kurrikula e studimeve BSc 2016 Aneksi 14.2: Plani mësimor 2018-2019 Aneksi 20: CV të personelit akademik të përfshirë në programin e studimit								
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Sikundërse u theksua për Kriterin 1 të këtij standarti, DAME përdor një larmishmëri formash dhe metodash standarte dhe të reja në mësimdhënie. Futja e teknikave të reja të prezantimit përmes përdorimit të video projektorëve, apo të formave interaktive të diskutimi në seminare, punë/detyra kursi dhe prezantime të formave të tjera mundësohet përfshirja e studentëve.								
<b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.	Gjatë vizitës në institucion, GVJ ju prezantua matja e rezultateve dhe performacës edhe përmes pjesëmarrjes së studentëve në orët e leksioneve dhe të seminareve. Sikundërse u referua pjesëmarrja e lartë është tregues interesi prej studentëve. Nga ana tjetër, takimi me grupin e studentëve konfirmoi përdorimin e teknikave të ndryshme që e bëjnë orën mësimore jo vetëm më tërheqëse, por edhe me efektive në përthithjen e njohurive dhe nxitjen e mendimit kritik.								
<b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Megjithatë, stafi akademik në takimin me GVJ theksoi se ky është një proces i vazhdueshëm përmirësimi dhe ndryshimi, që kërkon angazhim institucional dhe individual të përhershëm.								
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Asnjë përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">✓</td> </tr> </tbody> </table>	Asnjë përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				✓
Asnjë përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			✓						

**Standardi III.3**

**Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	DAME ka infrastrukturën e nevojshme për mësimdhënie në disa godina të UBT-së, të shpërndara në një rreze të vogël dhe të aksesueshme lehtësisht. Gjatë vizitës në Institucion, GVJ vëzhgoi mjediset në funksion të zhvillimit të programit të mësimi, salla leksionesh dhe mjedise laboratorike të përdorura në këtë program studimi. Mjediset janë rikonstruktuar vitet e fundit dhe janë në gjendje të mirë. Auditorët mësimorë të vizituar kanë kapacitete të mjaftueshme deri në 50-60 studentë. Ata janë të pajisur me sistem ventilimi/kondicionimi me pajisje individuale, video-projektorë me mundësi për tu lidhur me laptopë/kompjuter, tabela shkrimi me lapustila. Hapësira dhe ndricimi garantojnë një proces mësimor optimal, teorik e praktik dhe me nivele të larta të mësimdhënies.
<b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	RVB konfirmon se hapësira në dispozicion përbush standartin e përcaktuar në VKM 418 (2017) për 2.5 m <sup>2</sup> /student.

	<p>Laboratorët mësimorë janë të pajisur me bazë materiale. Pajisjet janë për përdorim në grupe studentësh. GVJ vërejtë se laboratorët kanë nevojë për përmirësimin dhe rifreskimin e pajisjeve dhe mjeteve të laboratorit në mënyrë që të rritet gama e punëve praktike të kryera në to.</p> <p>Aneks 42: Të dhëna për infrastrukturën në programin e studimit</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>Gjatë vizitës GVJ u informua për dy salla kompjuterësh të lidhur me internet në nivel universiteti, të cilat janë në dispozicion të stafit akademik dhe studentëve.</p> <p>Takimi me stafin dhe studentët konfirmoi nxitjen e përdorimit e programeve kompjuterike bazë, po nuk ka programe specifike profesionalë të referuar.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Shqyrtimi i DVV (syllabusët e lëndëve) si dhe takimi me stafin e programit të studimit, mundëson GVJ të konfirmojë së çdo lëndë ka literaturën e sugjeruar bazë dhe ndihmëse. Ajo ofrohet në formën e librave të shtypur të cilët janë dispozicion të studentëve në mjedise të përcaktuara të UBTsë. Gjithashtu literatura ndihmëse apo ajo në shërbim të elementëve pjesorë (tema seminaresh, detyrash kursi, etj) ofrohet si informacion digjital (version pdf ose faqe interneti) ose përmes bibliotekës së UBTsë.</p> <p>Gjatë vizitës në UBT, GVJ vëzhgoi edhe mjediset e Bibliotekës Shkencore "Mentor Përmeti". Pas dëmtimit në 1997, Biblioteka ka një fond prej 30,000 librash dhe revista në gjuhën shqipe dhe të huaja për fusha të ndryshme studimi si dhe 5,000 volume periodiku (shqip dhe të huaj). Në të u prezantua edhe një fond i ri në drejtimet e programit të studimit për nevojat e studentëve dhe stafit akademik për kërkimin shkencor dhe mësimin. Biblioteka ka krijuar edhe katalogun on-line.</p> <p>Biblioteka ka sallën me 12 kompjuterë të lidhur me internet nëpërmjet të cilëve mund të shfrytëzohet fondi online TEEAL (The Essential Electronic Agricultural Library) aplikuar në UBT. Veç kësaj mund të shfrytëzohen edhe burime të tjera online pa pagesë (p.sh., Google site; MOODLE, Research4life me pesë programet Hinari, AGORA, OARE, ARDI, GOALI). Salla e kompjuterëve shfrytëzohet nga studentët edhe për përgatitjen e detyrave dhe projekteve të kursit sipas programeve të studimit Bazuar në Planin Strategjik për Zhvillimin e Programit, biblioteka harton planin për shtimin e fondit të saj me tituj të rinj apo abonime në revista shkencore.</p> <p>Mundësimi prej RASH i bibliotekës on line do të ndihmojë studentët më tej në përmbushjen e nevojave të tyre dhe stfin pedagogjik për të zgjeruar gamën e burimeve të literaturës on line.</p> <p>Gjatë takimeve me studentët dhe stafin akademik u theksua se përdorimi i burimeve të bibliotekës rritej kur studentëve u jepeshin detyra konkrete.</p> <p>Aneksi 3.1. Plani Strategjik i Zhvillimit të UBT-së, 2016-2025.</p> <p>Aneksi 42. Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit</p> <p>Aneksi 45. Lista e teksteve /periodikëve në Bibliotekë të shtuar vitet e fundit.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe</p>	<p>Shqyrtimi i DVV (syllabusët e lëndëve) si dhe takimi me stafin e programit të studimit, mundëson GVJ të konfirmojë së çdo lëndë ka literaturën e sugjeruar bazë dhe ndihmëse. Ajo ofrohet në formën e librave të shtypur të cilët tregtohen në mënyrë të organizuar prej UBTsë. Gjithashtu literatura</p>

komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.	ndihmëse apo ajo në shërbim të elementëve pjesorë (tema seminaresh, detyrash kursi, etj) ofrohet si informacion digjital (version pdf ose faqe interneti) ose përmes bibliotekës së UBTsë.
<b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	Gjatë vizitës në UBT, GVJ vëzhgoi edhe mjediset e Bibliotekës Shkencore "Mentor Përmeti". (shih kriterin 3 për më shumë informacion) Gjatë takimeve me studentët dhe stfin akademik u theksua se përdorimi i burimeve të bibliotekës rritej kur studentëve u jepen detyra konkrete.  Aneksi 3.1. Plani Strategjik i Zhvillimit të UBT-së, 2016-2025. Aneksi 42. Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit Aneksi 45. Lista e teksteve /periodikëve në Bibliotekë të shtuar vitet e fundit.
<b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	Departamenti i Agromjedisit dhe Ekologjisë DAME disponon dy laboratorë mësimorë, të cilët u vizituan gjatë ditëve të vizitës në institucion. Përdorimi i tyre ishte dedikuar orëve laboratorike për të gjithë ciklet e studimit me kapacitete deri në 15-20 studentë, ku puna kryesisht organizohej e grupuar. Në shtesë, funksionon Laboratori Shkencor i Mjedisit, i cili është i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit për analiza në fushën e tokës, mbetjeve dhe ujërave. Laboratori është në dispozicion të procesit mësimor dhe kërkimit shkencor. Laboratori siguron kushtet mjedisore të përshtatshme dhe pajisjet e nevojshme për aktivitetin laboratorik të testimit. Laboratori është në pajtueshmëri të plotë me Standardet S SH ISO/IEC17025:2006  Anekset 42. Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit. Aneksi 14_20. Çertifikata e Akreditimit LAME_2014_2018.
<b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Sikundërse referohet edhe RVB, Institucioni është angazhuar në përdorimin e teknologjive të reja të informacionit për përmirësimin e mësimdhënies dhe kualifikimin e mëtijshëm të stafit. Disa nga instrumentet që përdoren përfshijnë: <ul style="list-style-type: none"> <li>• E-learning - që përfshin të gjitha format e të mësuarit dhe të dhënies së mësimi, e cila zhvillohet me ndihmën e pajisjeve elektronike. Me këto metoda, materialet e shtypura zëvendësohen me versione elektronike si dokumente, materiale të bashkëngjitura, prezantime poëer-point, audio, video, teste, forume, animacione etj.</li> <li>• Moduli online "Njohuria mbi informacion" - Studenti mëson se si të gjejë informacionin e duhur që u shërben për të shkruar një detyrë/punë shkencore, duke shfrytëzuar tre llojet e burimeve të informacionit; si ta vlerësojnë atë, duke përdorur filtrat e nevojshëm; dhe si ta përdorin informacionin në mënyrë efektive në dobi të tyre, duke adresuar siç duhet nevojat e detyrës/punës shkencore.</li> <li>• TEEAL - Biblioteka Themelore Elektronike Bujqësore, është një bazë të dhënash me tekste të plotë të artikujve nga më shumë se 450 revista kërkimore, me cilësi të lartë në fushën e bujqësisë dhe në shkencat e lidhura me të.</li> </ul> Për sa më sipër, GVJ konstaton se metodat ndihmojnë stafet akademike dhe studentët me forma të qëndrueshme dhe të standardizuara të shpërndarjes së të nxënit.




<p><b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ u prezantua me disa metoda komunikimi të stafit akademik dhe studentëve:</p> <p>Google site - Me anë të këtij aplikacioni mund të mblidhen lehtë dhe shpejt një sërë informacionesh në një site të vetëm. Studentët nëpërmjet google site kanë mundësinë të aksesojnë materialet e leksioneve dhe informacionet e digjitalizuara, të ngarkuara nga pedagogu.</p> <p>Sistemi ESSE3, sistem i menaxhuar nga RASH, është një sistem i integruar për menaxhimin e mësimdhënies dhe shërbimeve drejtuar studentëve, nga aplikimi në Universitet, jetës universitare deri në mbrojtjen e diplomës. Qëllimi kryesor është vënia në punë e një sistemi informativ për të digjitalizuar punën dhe procedurat mësimdhënëse, procedurat administrative të sekretarive mësimore të universitetit</p> <p>Anekset 45: Informacione rreth bibliotekës Aneksi 46.2: Manual përdorimi rreth Google apps Anekset 47.4-47.5: shembull përdorimi te sistemeve on-line</p>			
<p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>	<p>Rregulloret e funksionimit të FBM dhe DAME shprehin se pedagogët e kanë detyrë funksionale të orientojnë studentët në mënyrën e organizimit dhe përmbajtjen e provimit të formimit.</p> <p>Në mënyrë të vecantë Aneksi 7.1 përshkruan procedurën dhe organisimin e diplomave apo të provimit të formimit.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar: Aneksi 5.1: Rregullore e studimeve UBT Aneksi 6.1: Rregullore e FBM 2017-2018 Aneksi 7.1: Rregullore e programit të studimit</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">✓</p>

#### Standardi III.4

**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>GVJ konfirmon se Sektori i Zhvillimit të Kurrikulave dhe Vlerësimit Institucional, në nivelin e UBTsë vlerëson në mënyrë të rregullt, në perioda vjetore, përmes përfshirjes së studentëve me anë të një pyetësori.</p> <p>Çdo fillim viti akademik, SZKV përgatit një komunikim për te gjitha njësitë, duke udhëzuar lidhur me strukturën dhe organizmin e procesit mësimor në atë vit akademik.</p> <p>Struktura e vlerësimit të cilësisë është e ndërtuar edhe në nivel Fakulteti, pranë FBM.</p> <p>Aneksi 5.1: Rregullore e studimeve universitare Aneksi 6.1: Rregullore e brendshme e FBM Aneksi 13: Manual i cilësisë në UBT 2018</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe</p>	<p>GVJ konfirmon se në kuadër të analizës vjetore të punës së DAME dhe përmes pyetësorëve me studentët të organizuar në nivel UBT (prej Sektorit të Zhvillimit të Kurrikulave dhe Vlerësimit Institucional,</p>



<p>studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>vlërësohet në mënyrë të rregullt, vjetore niveli dhe aftësitë mësimdhënëse të personelit akademik të këtij programi studimi. Gjatë vizitës në institucion, GVJ është informuar mbi procedurën e ndjekur prej këtij sektori dhe mbi shkallën e performancës për çdo lëndë në këtë program. Të dhënat e vlerësimit vihen në dispozicion të përgjegjësit të DAME për tu diskutuar më pas me secilin personel akademik.</p> <p>Aneksi 5.1: Rregullore e studimeve universitare Aneksi 6.1: Rregullore e brendshme e FBM Aneksi 13.1: Manual i cilësisë në UBT 2018</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>GVJ pohon se gjatë takimeve me stafin akademik, sikundërse referohet edhe në RVB, janë cituar një numër leksionesh të hapura nga pedagogë të njësisë bazë apo edhe të ftuar. Ndonëse nuk ka një listë të shprehur qartë me data, vendin dhe lektorin, kjo praktikë është referuar në disa raste.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Sikundërse është pohuar prej GVJ, kualifikimi i stafit akademik është kryer kryesisht përmes pjesëmarrjes në konferenca shkencore dhe aktivitete shkëmbimi me institucione homologe jashtë vendit. Tregues të ecurisë shërbejnë botimet shkencore dhe lista e programeve të shkëmbimit ku stafi i DAME ka marrë pjesë.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Nga Aneksi 43.2 Trajnimi i stafit akademik, në periudhën 5 vjecare 2014-2019 referohet se nga 22 personel 13 janë trajnuar në 25 kurse të ndryshme trajnimi, kryesisht jashtë vendit.</p> <p>Aneks 20: CV të stafit akademik Aneks 43: Të dhëna mbi kërkimin shkencor në DAME Aneksi 43.2 Të dhëna mbi trajnimin e stafit akademik</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Rregulloret e Njësisë bazë dhe të programit të studimit shprehin qartë përgjegjësinë ligjore dhe funksionale të stafit të DAME për mbarëvajtjen e procesit mësimor. Ato përcaktojnë si detyrë funksionale të personelit të DAME arritjen e objektivave më të lartë në cilësinë e punës mësimore dhe shkencore.</p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>GVJ konfirmon se në kuadër të analizës vjetore të kryer çdo vit nga DAME për ecurinë e zbatimit të programit të studimit, kryhet vlerësimi i metodave të reja, nëse ka pasur, dhe stimulohet futja dhe përdorimi i tyre kur vlerësohen të efektshme. Kështu, në takimin me stafin akademik është vlerësuar i efektshëm përfshirja e studentëve në detyra kursi dhe prezantime në grupe të vogla pune.</p> <p>Anekset 38: Analizat e punës mësimore në DAME</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				✓

### Standardi III.5

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

<b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Rregulloret e studimit (Aneksi 7.1) shprehin qartë mënyrën e vlerësimit me provim ose në mënyrë të vazhduar. Plani mësimor (Aneksi 14.2) paraqet qartë shpërndarjen e pikëve të fituara nga vlerësimi i vazhduar dhe ai në provimin përfundimtar.</p> <p>Njohja e studentëve me mënyrën e vlerësimi është e përcaktuar në rregullore të ndodhë në fillim të ciklit të studimit dhe në fillim të cdo lënde kur pedagogu njih studentin me programin e lëndës.</p> <p>Gjithashtu, pedagogët në faqet e tyre personale në internet apo dhe nëpërmjet kontakteve direkt japin informacion të hollësishëm për studentët për progresin në lëndët e tyre. ZKS ndihmon studentët të orientohen në gjetjen e informacionit të nevojshëm në mënyrën më të përshtatshme.</p> <p>Aneksi 7.1: Rregullore e studimeve ne ciklin e studimeve të programit Aneksi 14.2: Plani mësimor 2018-2019</p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në sylabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>GVJ pohon se gjatë takimeve në institucion me stafin akademik, praktika e njoftimit të detyrimeve të studentit, metodologjia e vlerësimit dhe përshkrimi i sylabusit të lëndës është detyrim ndaj çdo pedagogu/titullari dhe përmbushet në fillim të procesit mësimor për atë lëndë.</p> <p>Gjithashtu, studentët vlerësuan se ndjehen mjaftueshmërisht të informuar përmes pedagogëve për detyrimet e tyre dhe mënyrën e operimit për çdo lëndë specifike.</p> <p>Aneks 7.1: Rregullore e programit të studimit Aneks 19: Sylabuset e lëndëve</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Sikundërse referohet në RVB, dhe konfirmuar prej GVJ gjatë vizitës në institucion, vlerësimi i dijeve realizohet në formate të ndryshme:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Vlerësimi i vazhduar përmes kontrolleve të njohurive të marra gjatë procesit mësimor, në periudha të ndërmjetme (referohet java e tetë e semestrit)</li> <li>2. Detyrat e kursit, të cilat janë individuale dhe përmbushen gjatë vitit mësimor</li> <li>3. Testimi përfundimtar.</li> </ol> <p>Mënyra e vlerësimit në testin final është me shkrim, me gojë ose në format të kombinuar.</p> <p>Kjo mënyrë vlerësimi është e shprehur në rregulloret e funksionit të institucionit dhe të programit të studimit dhe ju bëhet e ditur studentëve në fillim të programit mësimor të ciklit të dytë.</p> <p>Aneks 7: Rregullore e programit të studimit Aneks 19: Sylabuset e lëndëve</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				✓

**Standardi III.6**

<b>Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.</p>	<p>Sipas DVV dhe verifikimit gjatë vizitës në insitucion, DAME si njësia përgjegjëse organizon dhe menaxhon procesin e testimit dhe të vlerësimit të njohurive për programin e studimit.</p> <p>Vlerësimi bëhet me notë sipas sistemit me 10 nota. Vlerësimi ndahet në dy pjesë sikundërse paraqitet edhe në sylabusin e lëndës: Vlerësimi i vazhduar i kryer gjatë procesit mësimor zë nga 30%-40% të vlerësimit përfundimtar. Takimi me stafin akademik konfirmon se kjo është një mënyrë për të nxitur mësimin e vazhduar prej studentëve dhe arritjen e rezultateve më të mira në përfundim, Ndaj tendenca është kalimi drejt 50% në disa lëndë të veçanta.</p> <p>E drejta për tu futur në provim vlerësohet nga pedagogu i lëndës pas përmbushjes së detyrimeve të lëndës gjatë procesit mësimor.</p> <p>Testimi i kryer në provimin përfundimtar të lëndës kryhet më shkrim, me gojë ose në mënyrë të kombinuar.</p> <p>Aneks 5.1: Rregullorja e studimeve në UBT Aneks 6.1: Rregullorja e FBM 2017-2018 Aneks 7.1: Rregullorja e studimeve në programin Inxhinieri Agromjedisi Aneks 19: Sylabuset e lëndëve</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Sikundërse referohet në RVB, institucioni nuk ka sisteme të vlerësimit elektronik. Forma e përdorur është ajo standarde me shkrim.</p> <p>Informimi lidhur me rezultatet e provimit jepen në sistemin ESSE3</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Komisioni i provimit ngrihet prej përgjegjësit të DAME, me të paktën dy anëtarë të stafit akademik, ku njëri është titullari i lëndës. Të dy anëtarët marrin pjesë në provim dhe vlerësimin e studentit.</p> <p>Në takimet me stafin dhe studentët nuk janë referuar problematika lidhur me këtë mënyrë vlerësimi/kontrolli të dijeve.</p> <p>Procedura e ngritjes dhe funksionimit të komisioneve të provimit është e përshkruar në rregulloret e institucionit.</p> <p>Aneks 5.1: Rregullorja e studimeve në UBT Aneks 6.1: Rregullorja e FBM 2017-2018 Aneks 7.1: Rregullorja e studimeve në programin Inxhinieri Agromjedisi</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>GVJ konfirmon shprehjen në RVB se testimi me anë të provimit bëhet i sekretuar. Procesi i sekretimit kryhet nga personeli ndihmës mësimor.</p> <p>Procesi i sekretimit ende nuk kryhet me infrastrukturë të posaçme/veçantë.</p> <p>RVB thekson se UBT është në procesin e futjes së një sistemi të sofistikuar sekretimi me kod bar, i cili pritet të vihet në funksionin vitin e ardhshëm. Me këtë sistem të ri pritet të rritet më tej transparenca dhe paanshmëria në vlerësimin e njohurive të studentëve në testet përfundimtare.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i</p>	<p>GVJ konfirmon se gjatë procesit të vlerësimit të elementëve të një moduli si testi i ndërmjetëm, detyrat e kursit dhe provimi final i lëndës; stafi</p>

<p>cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>akademik bën komente të korrigjimit në rastin e provimeve ose komente të drejtpërdrejta në provimet me gojë në detyrat e kursit që ndihmojnë studentin në përmirësimin e njohurive dhe sqarimin e paqartësive që mund të lindin në këtë proces.</p> <p>Për këtë qëllim studentët kanë periudhën e ankimit pasi janë njohur me vlerësimin në sistemin ESSE 3</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	<p>DAME konfirmon seriozitetin në kryerjen e testimit përmes mos lejimit të personave të jashtëm të futen në provim, respektimin e orarit dhe masave parandaluese për kopjimin.</p> <p>Lidhur me plagjiaturën, GVJ ka konstatuar se ajo synohet të parandalohet përmes komunikimit pedagog student, por ende nuk ka një mjet (softëare) vlerësues në përdorim të njësisë bazë për këtë qëllim.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Vlerësimi gjatë vitit dhe në fund të programit mësimor, me anë të testimit, siguron vlerësimin korrekt të njohurive të fituara në bazë të meritës.</p> <p>Përcaktimi i qartë i ndarjes së pikëve, i paraqitur edhe në fletën e vlerësimit përfundimtar dhe i standartizuar mundëson matjen objektive të arritjeve të studentëve.</p> <p>Me anë të testimit grumbullohet opinioni i studentëve për procesin e vlerësimit dhe të kontrollit. Komentet e studentëve reflektohen në analizën vjetore. Nëpërmjet këtyre anketimeve studentët shprehen edhe mbi ndershmërinë dhe barazinë në procesin e vlerësimit të dijeve.</p> <p>Aneksi 40.6. Pyetësor i Studentëve.</p> <p>Aneksi 40.7. Analiza e Rezultateve të Anketimit.</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Në bashkëpunim me Rrjetin Akademik Shqiptar, UBT ka ndërtuar një sistem për menaxhimin e informacionit online bazuar mbi platformën ESSE3. Ky sistem menaxhon gjithë informacionin dhe dokumentet e stafit akademik, ndihmës e administrativ.</p> <p>Përmes këtij sistemi studentët njihen me vlerësimin e tyre dhe kanë dy ditë kohë për të shprehur ankimitin e tyre në rast se kanë opinionin e një vlerësimi të padrejtë. Studentit i garantohet e drejta të njihet me vlerësimin dhe në rast opinionin të kundërt me vlerësimin mund ti drejtohet Përgjegjësit të Njësisë bazë ose FBM me një ankesë, e cila shqyrtohet prej tyre. Drejtuesi i njësisë bazë mund të ngrejë edhe një komision të vecantë për shqyrtimin e ankesave dhe rishikimin e provimit.</p> <p>Aneksi 7.1 Rregulloret e programit të studimit.</p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimit, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>GVJ ka konfirmuar në takimin me studentët se ata kanë të drejtën të ankimojnë vlerësimin kur e gjykojnë të padrejtë. Ankesat shqyrtohen nga Përgjegjësi i DAME dhe/ose Dekani i FBM.</p> <p>Në shtesë të përdorimit të pyetësorëve për të vlerësuar zbatueshmërinë e përcaktimeve për kontrollin e dijeve dhe të procedurave të ndjekura, sikundërse paraqitet në rregulloret e institucionit në DVV sigurohet përfshirja e studentëve në organet vendimmarrëse e këshilluese të UBT.</p> <p>Gjatë takimit me studentët ata theksuan se kanë përfaqësuesin e tyre në Senatin e UBT dhe komisionet e ndryshme të FBM (Komisioni i Etikës, Komisioni për Sigurimin e Cilësisë së Programit të studimit dhe Kërkimit Shkencor). Studentët u shprehen se përfaqësuesit e tyre arrijnë të përcjellin informacionin nga lart poshtë dhe shqetësimet e tyre nga poshtë lart.</p>

	Aneksi 2.1. Statuti i UBT-së. Aneksi 5.1. Rregullorja e studimeve UBT Aneksi 6.1. Rregullore e FBM 2017 – 2018			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			✓	

<b>Standardi III.7</b>	
<b>Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Bazuar në DVV, GVJ konfirmon se kurrikula e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në Inxhinieri Agromjedisi është hartuar të japë njohuritë bazë për menaxhimin në fushën e mjedisit dhe të bujqësisë duke nxitur dhe zhvilluar aftësi profesionale të studentëve në këtë fushë. Kjo kurrikulë ka në përbërje lëndë ku merren njohuri më të thelluara (kryesisht në vitin e tretë të studimeve). Të gjitha këto lëndë janë në funksion të formimit të shprehive të veçanta për shumë profesione dhe specialitete të fushës së menaxhimit në ferma dhe impjante bujqësore dhe blektorale, njësi vendore e kompani prodhimi të kësaj fushe veprimtarie. Programi Bachelor ofron dije dijet dhe njohuritë bazë duke synuar hapjen e mundësive për zhvillim të mëtejshëm profesional përmes kurseve specifike apo studimeve në ciklin e dytë. Aneksi 14: Kurrikula e studimeve në BSc.
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Shqyrtimi i Planit mësimor (Aneksi 14.2) konfirmon se Programi i studimit ofron njohuri në fushën e Teknologjisë së Informacionit e Shkencave të komunikimit. Në planin mësimor përmban lëndë ndërdisiplinore si Informatikë, Sociologji, etj. Këto i japin mundësi studenti të kuptojë tregun e punës, të jetë më komunikues, të punojë në grup, të përdorë Teknologjinë e informacionit dhe të fitojë terminologjinë e duhur mjedisore në Anglisht. Aneksi 14.2: Plani mësimor 2018-2019
<b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	Gjatë vizitës në institucion, GVJ pohon se në përfundim të lëndës stafi akademik bën vlerësimin e nivelit të kompetencave të fituara sipas syllabusit. Njësia organizon rishikimin periodik të programit të studimit dhe rregullores mësimore të tij. Ky rishikim bëhet në bazë të ecurisë së studentëve në lëndë për nivelin e kompetencave dhe aftësive të fituara dhe konkluzionet nxirren në analizën vjetore të DAME. Janë rishikuar kreditet, modulet e lëndëve, baza e nevojshme didaktike për realizimin e programit të studimit, i literaturës së përdorur, procedurat e kontrollit të dijeve dhe rezultatet e kontrollit.
<b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe	Analiza vjetore e punës në DAME merr në shqyrtim ecurinë e punës dhe rezultatet e fituara për çdo lëndë. Personeli akademik në përfundim të çdo lënde bën përmbledhjen e temave ku studenti duhet të fokusohet

orienton studentët për implementimin e tyre.	për provimin dhe demontron raste praktike nga vite të mëparshme. Në këtë mënyrë studentët ndihmohen të fokusohen më mirë në përmbajtjen e programit dhe për testimin e dijeve në përfundim sipas rregullores përkatëse  Aneks 6.1: Rregullore e brendshme e FBM 2017-2018 Aneksi 7.1: Rregullore e programit të studimit Inxhinieri Agromjedisi Aneksi 14.1: Kurrikula e studimeve në BSc
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Ndonëse niveli bachelor ofron njohuritë bazë të informacionit dhe dijeve, GVJ konfirmim se studentët e interesuar ftohen në orët e hapura të leksioneve (gjatë 2017 referohen 17 leksione të hapura në Aneksin 38.3) dhe angazhimin e studentëve në praktika laboratorike për përshkrimin dhe informimin e kompetencave të reja dhe zhvillimeve teknologjike.  Formimi i studentëve me kompetenca të reja realizohet përmes dhënies së detyrave të kursit në lëndë dhe tematika të ndryshme, ku studenti duhet të punojë individualisht dhe të paraqesë rezultatet e punës së tij në mënyrë individuale apo në grup, sipas specifikimeve të dhëna nga pedagogu i lëndës.  Aneksi 38.3: Leksionet e hapura
<b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	
<b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	
<b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.	
<b>Kriteri 9.</b> Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.	DAME ka përdorur dhe mundësitë e krijuara nga EDE (Ekonomia Didaktike Eksperimentale), e cila ka për qëllim kryesor të realizojë punën kërkimore-shkencore dhe funksionin didaktik dhe eksperimental për pedagogët dhe studentët e universitetit për kryerje e studimeve të ndryshme dhe praktikave profesionale.  Gjatë takimeve, GVJ u informua se Departamenti ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione e subjekte të tjera, të cilat iu garantojnë studentëve kryerjen e praktikave mësimore dhe profesionale. Në këtë nivel studimi këto praktika kanë më shumë karakterin e vizitave njohëse me sistemet e prodhimit dhe teknologjitë në përdorim.  Aneksi 42. Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit.
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Për rritjen e aftësive krijuese dhe zbatuese të studentëve dhe për të marrë njohuritë e nevojshme ka ndërthurrur shkëmbimet e mobilitetit të studentëve dhe pedagogëve. Gjatë vizitës në institucion, GVJ u informua se një numër studentësh janë të përfshirë në programe shkëmbimi ERASMUS+. Sipas Aneksit 28.2 referohet se gjatë 2017-2018 janë përfshirë në programe shkëmbimi 17 studentë të këtij programi studimit.  Studentët e programit Bachelor (kryesisht në vitin e tretë të studimeve kanë konfirmuar dobinë e shkëmbimeve të tilla, duke shkuar në universitete homologe evropiane për cikle/module disa mujore. Institucioni ka mundësia njohjen e krediteve për lëndët e realizuara në kuadër të këtyre shkëmbimeve.

	Gjatë takimit me studentët e këtij programi, GVJ ka konfirmuar shkallën e njohjes për mundësinë e pjesëmarrjes në këto shkëmbime dhe ka diskutuar me disa prej studentëve përfitues. Aneks 28.1: Tabelë e mobiliteteve të studentëve në programin ERASMUS			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Niveli i përmbushjes</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				✓

<b>Standardi III.8</b>	
<b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	GVJ konfirmon se procesi i diplomimit përmbillet me provimin e formimit në fund të semestrit të 6-të të studimeve. DAME në bazë të rregullores ka procedurë të posaçme dhe e paraqet në faqen e UBT dhe stendat e DAME. Në rregulloren e FBM përcaktohen kriteret dhe mënyra e organizimit të provimit të formimit apo diplomës. Gjithashtu DAME ka përgatitur udhëzues të vecantë për diplomën (Aneksi 14.9). Provimi zhvillohet me gojë përpara Komisionit të provimit. Tezat e provimit hartohen nga titullarët e lëndëve, të cilët krijojnë një bankë të pyetjeve prej të cilave përzgjidhen ato që vlerësohen më të përshtatshme për çdo lëndë.  Aneks 5.1: Rregullore e studimeve UBT Aneksi 6.1: Rregullore e studimeve në DAME 2017-2018 Aneksi 14.9: DAME Udhëzime për mikrotezën
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	GVJ konfirmon se DAME e realizon mbështetjen për studentët për provimin përfundimtar apo përgatitjen e diplomës (për studentët që arrijnë mesatare të lartë). Stafit akademik jep udhëzimet e nevojshme dhe materialet e duhura për tematikat kryesore dhe mënyrën e organizimit të provimit të formimit.
<b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Provimi i formimit apo prezantimi i diplomës mbrohet/kryhet përpara komisionit të posaçëm me antarë të departamentit. Ai miratohet nga Dekani. Kryetari i Komisionit është përgjegjësi i departamentit. Kriteret e vlerësimit përfshijnë cilësinë e përgjigjes, prezantimit prej studentit ndaj pyetjeve të komisionit.  Aneks 5.1: Rregullore e studimeve UBT Aneksi 6.1: Rregullore e studimeve në FBM 2017-2018
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/diplomave.	Gjatë takimeve me stafin akademik është theksuar se procesi i përgatitjes së studentëve për provimin e formimit vlerësohet i rëndësishëm dhe merr vëmendjen e duhur.

<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Studentëve u vihet në dispozicion materiali për studim dhe kanë mundësi të sqarojnë pyetje që lindin gjatë periudhës së përgatitjes për provimin e formimit.</p> <p>Njësia bazë DAME, gjatë vizitës në institucion ka referuar se për studentët me rezultate më të larta jepet edhe alternativa e paraqitjes së një diplome. Në kësi raste, studenti ka një drejtues dhe përgatit një punim i cili prezantohet përpara komisionit të diplomave dhe vlerësohet sipas kriterëve për vlerësimin e diplomave.</p> <p>Për shkak të numrit të madhe të studentëve në program dhe ngarkesës së stafit akademik, dominon mbrojtja me anën e provimit të formimit.</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Aneksi 14.9: DAME Udhëzime për mikrotezën</p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Sipas DVV dhe konfirmimit të marrë gjatë vizitës në institucion, dhe të dhënave të depozituara në Sekretarinë mësimore konfirmohet se vlerësimi bëhet me notë në sistemin me dhjetë nota.</p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Bazuar në rregulloret e institucionit, studenti pajiset me Diplomën dhe suplementin e diplomës të miratuar nga MASR</p> <p>Aneksi 5: Rregullore e studimeve ne UBT Aneksi 15.3 Suplementi i diplomës</p>			
<p><b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>GVJ konfirmon se kopje të dokumentacionit për studimet e kryera mund të tërhiqen nga studentët pranë sekretarisë mësimore brenda kohës së përcaktuar.</p>			
<p><b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.</p>	<p>Gjithë informacioni për studentët ruhet pranë sekretarisë mësimore dhe mund të tërhiqet prej studentëve të interesuar bazuar në kërkesën e tyre me shkrim</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b></p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓






#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>GVJ kreu vizitën në Zyrën e Burimeve Njerëzore (ZBNj) pranë Rektoratit të Universitetit Bujqësor të Tiranës ku dhe kërkoi të vlerësonte përputhshmërinë e dokumentacionit me kërkesat e Rregullores së Zyrës së Burimeve Njerëzore.</p> <p>Dosjet e shqyrtuara ishin te rregullta. Ato përmbanin CV të përditësuar; Diplomë dhe listë notash; Trainime dhe kualifikime të ndryshme; vendime të Titujve dhe Gradave; Foto; Listë të publikimeve dhe artikujve të botuar.</p> <p>Bazuar në shqyrtimin e mësipërm si dhe në diskutimin me personelin e ZBNj, GVJ është i mendimit se të dhënat e personelit të programit të studimit janë të mbledhura, të ruajtura dhe të përditësuara në mënyrë të përvitshme.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Përputhshmëria e procedurave për rekrutimin e personelit akademik me bazën ligjore në fuqi u verifikua pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore. GVJ u njoh me procedurat dhe vlerëson se ato janë në përputhje me Rregulloren e Rektoratit të Universitetit Bujqësor si dhe Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Procedurat e rekrutimit përfshijnë shpalljen publike të vendit të punës në Buletinin e APP-së, hartimin e ofertës së punës, ngritjen e komisioneve, vlerësimin e dosjeve, zhvillimi e konkursit, relacionin përfundimtar dhe vendimin e emërimit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në Dosjen e Vetëvlerësimit (DVV), rezulton se institucioni ka hartuar procedura dhe kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, siç përcaktohet në Rregulloren e Rekrutimit të Stafit Akademik, Ndihmës dhe Administrativ në UBT. Objekti i kësaj rregullore është përcaktimi i rregullave standarde për mënyrën e rekrutimit të personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ. Ajo përfshin rregulla, kritere &amp; standarde për rekrutimin të personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>GVJ u informua mbi procedurat e rekrutimit nga drejtuesi i Zyrës së Burimeve Njerëzore që sqaroi se nevoja për rekrutim të personelit lind në Departamentin përkatës. Përgjegjësi i Departamentit e përcjell kërkesën tek Dekani i Fakultetit i cili e aprovon duke e transmetuar në Rektoratin e UBT. Më pas kjo kërkesë paraqitet në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore e cila bën shpalljen e vendit të punës në Buletinin e APP.</p> <p>Rregullorja e rekrutimit përcakton shpalljen dhe zbatimin e kritereve të përgjithshme dhe të veçanta për çdo pozicion. Kriteret e përgjithshme përcaktohen nga SENATI i UBT-së ndërsa kriteret e veçanta</p>

	përcaktohen nga departamenti dhe dekani përkatës për tu miratuar nga Rektori. Më vonë kryhet shpallja e konkursit, duke bërë publike kriteret e përgjithshme dhe të veçanta, komisionin përzgjedhës, ditën, orën, dhe vendin e dorëzimit të dokumenteve dhe/ose intervistës me të interesuarin.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				✓

**Standardi IV.2****Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	GVJ u njoh gjatë vizitës së tij me mjediset e punës, laboratorët, sallat e leksioneve dhe seminareve, bibliotekat etj. Nga kjo vizitë rezultojnë se mjediset janë të përshtatshme, të mjaftueshme dhe lirisht të aksesueshme nga personeli për kryerjen e detyrave në mënyrë profesionale. Po kështu, i gjithë stafi ka mundësi të përshtatshme në kualifikimin shkencor mbështetur në programet e punës dhe marrëveshjeve me institucione të tjera e sidomos me homologët gjermanë.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	Shqyrtimi i DVB dhe takimi me Përgjegjës të Departamentit dhe GVB dha mundësinë për të njohur GVJ me angazhimin e institucionit për kualifikimin e vazhdueshëm të stafit. Mbështetur në sa më sipër rezultojnë se personeli përgjegjës për administrimin e programit të studimit ka marrë pjesë në konferenca shkencore, kombëtare dhe ndërkombëtare, nxjerr botime në revista shkencore dhe merr pjesë në projekte kombëtare e ndërkombëtare. Sipas informacionit të paraqitur në Aneksin 43.1. Të dhëna për kërkimin DAME, rezultojnë se stafi akademik, gjatë periudhës 2016-2018 ka shënuar: <ul style="list-style-type: none"> <li>• 56 prezantime në konferenca ndërkombëtare të organizuara brenda dhe jashtë vendit,</li> <li>• 79 artikuj dhe punime të publikuara në revista shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare.</li> </ul>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	Nga diskutimi me stafin akademik të Departamentit si dhe nga shqyrtimi i DVV-se del në pah se institucioni përdor teknologjitë e reja si më poshtë: <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Platforma "E-learning", metodë inovative ku materialet e shtypura zëvendësohen me versione elektronike;</li> <li>2. Google Site – ku çdo pedagog i UBT-së, zotëron një faqe dinamike, ku ngarkon dhe azhuron në mënyrë të vazhdueshme tekste, prezantime poëer-point, video dhe audio lidhur me fushën e studimit, lëndëve/moduleve përkatëse;</li> </ol>




	<p>3. Esse3, program i Ministrisë Përkatëse për Arsimin është një sistem i integruar për menaxhimin e shërbimeve për studentët ku studenti mund të monitorojë studimet e tij përmes një kodi unik identifikimi</p> <p>Stafi akademik është trainuar dhe përdor sot metodat e mësipërme.</p> <p>Ndërkaq në nivelin e mësimdhënies, sikurse konfirmohet dhe nga diskutimet me studentët, duket se formati përgjithësisht i përdorur është ai tradicional me një format leksionesh që duhet të mësohet dhe të interpretohet nga studenti në po këtë formë. Duket se studentëve u lihet pak hapësirë për të kërkuar në mënyrë aktive për një temë të dhënë. E gjitha kjo ka lidhje dhe me mungesën e aksesit në literaturën shkencore bashkëkohore.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Stafi i Departamentit të Mjedisit, përgjegjës për programin mësimor të Inxhinierisë së Mjedisit, është i përbërë nga tre anëtarë me Master Shkencor, tre Doktorë të Shkencave, dy Asistent Profesorë dhe 14 Profesorë. I gjithë stafi është i angazhuar në mësimdhënie dhe po kështu i gjithë stafi është i mbingarkuar. Kjo më sipër dëshmohet dhe nga Plani i Ngarkesës Mësimore të Stafit Akademik DAME (Aneksi 25.2).</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			✓	

### Standardi IV.3

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>GVJ vëzhgoi nga afër hapësirat e përdorura për zhvillimin e programit të mësimit dhe hapësirat e pedagogëve që mbulojnë këtë program studimi. GVJ pati mundësinë të shikonte disa auditorë mësimorë, të gjithë të kompletuar me kondicioner të ajrit, video-projektorë, tabela shkrimi etj.</p> <p>Po kështu duket se raporti i hapësirës për student dhe hapësirës për personel është dukshëm brenda normës së përcaktuar nga Vendimi Këshillit të Ministrave Nr. 418, datë 10.5.2017 “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre.”</p> <p>Sallat janë të pajisura me pajisje moderne elektronike për përdorimin e teknologjisë së informacionit (mjete audio-vizive, lidhje me internet). Sallat dhe mjetet garantojnë një proces mësimor optimal, dhe me nivele të larta të mësimdhënies.</p> <p>GVJ vizitoi edhe zyrat e stafit akademik të cilat ishin të kompletuara, komode, me jo më shumë se 2 pedagogë në çdo zyrë.</p>

<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Sikurse thënë më lartë, sallat janë të pajisura me pajisje moderne elektronike për përdorimin e teknologjisë së informacionit (mjete audio-vizive, lidhje me internet). Kështu është i garantuar dhe një proces mësimor optimal, teorik e praktik dhe me nivele të larta të mësimdhënies.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>GVJ vizitoi Laboratorin Shkencor të Mjedisit dhe Laboratorin e Kimisë.</p> <p>Laboratori Shkencor i Mjedisit është i akredituar për analizat e tokës dhe të ujit. Ky laborator është i mirëpajisur dhe kryen analiza të certifikuar edhe për të tretët.</p> <p>Laboratori i Kimisë është i pajisur me modeste pajisje dhe hapësirë. Të dy hapësirat përdoren nga studentët për të kryer punë të ndryshme praktike.</p> <p>Përgjithësisht, laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.</p>	<p>Pranë DAME-s funksionon që prej vitit 2010 “Laboratori Shkencor i Mjedisit”. Në këtë laborator kryhen të gjitha analizat e tokës dhe ujit. Laboratori Shkencor i Mjedisit është i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit për ruajtjen e Çertifikatës së Akreditimit me Nr. Regjistri: LT039, të lëshuar nga DPA. Ky proces certifikimi tregoi që i gjithë aktiviteti i kryer nga ky laborator ka qenë në pajtueshmëri të plotë me Standartet S SH ISO/IEC17025:201722.</p> <p>Laboratori është i pajisur me programe profesionale dhe përmban të gjithë teknologjinë e informacionit që nevojitet për formimin profesional të studentëve në fushën e mjedisit.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</p>	<p>Departamenti ka kapacitete materiale të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe mësimve praktike në terren.</p> <p>UBT ka në strukturën e tij EDE (Ekonomia Didaktike Eksperimentale), laboratorin kërkimor fushor për disa Fakultete, përfshirë FBM. EDE ka për qëllim kryesor të realizojë punën kërkimore-shkencore dhe funksionin didaktik dhe eksperimental për pedagogët dhe studentët e universitetit për kryerje e studimeve të ndryshme dhe praktikave profesionale.</p> <p>Por, kohët e fundit rezulton se në truallin e EDE do të ndërtohet një shkollë nga ana e Bashkisë së Tiranës. Ky ndërtim redukton hapësirat për kryerjen e praktikave profesionale.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				✓

#### Standardi IV.4

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Gjatë vizitës në UBT, GVJ pa edhe mjediset e Bibliotekës Shkencore "Mentor Përmeti". Sipas të dhënave të referuar nga punonjësit, biblioteka ka një fond prej 2000 librash në gjuhën shqipe dhe të huaj, për fusha të ndryshme studimi si dhe 5000 volume periodiku (shqip dhe të huaj). Kjo bibliotekë është e shtrirë në një sipërfaqe prej rreth 1300 m <sup>2</sup> dhe përballon nevojat e studentëve dhe stafit akademik për literaturë kërkimi dhe mësimi. Sallat e literaturës janë të organizuara me fonde të hapura të ndara sipas degëve të shkencës. Biblioteka ka krijuar edhe katalogun on-line.
<b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit.	Biblioteka ka edhe një sallë me 12 kompjuter të lidhur me internet nëpërmjet të cilëve mund të shfrytëzohet fondi online TEEAL (The Essential Electronic Agricultural Library) aplikuar në UBT. Veç kësaj mund të shfrytëzohen edhe burime të tjera online pa pagesë (p.sh., Google site; MOODLE, Research4life me pesë programet Hinari, AGORA, OARE, ARDI, GOALI). Salla shfrytëzohet nga studentet edhe për përgatitjen e detyrave dhe projekteve të kursit sipas programeve të studimit.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	Bazuar në Planin Strategjik për Zhvillimin e Programit, biblioteka harton planin për shtimin e fondit të saj me tituj të rinj apo abonime në revista shkencore. Ky plan përfshihet në projekt buxhetin e institucionit. Projektet e ndryshme ku janë përfshirë punonjësit e institucionit kanë ndihmuar me futjen e titujve të rinj të literaturës bashkëkohore.
<b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Biblioteka është e hapur nga e hëna në të premte prej orës 8.00 – 16.00. Biblioteka ofron shërbimet dhe kapacitetin e saj pa pagesë e në mënyrë të barabartë për të gjithë studentët dhe stafin e regjistruar.
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	Biblioteka harton një plan të detajuar për të shtuar fondin ekzistues të saj me tituj të rinj, abonimin në revista shkencore e periodike. Këtë plan Biblioteka e paraqet në Rektorat dhe plani i modifikuar bëhet pjesë e Planit Strategjik për Zhvillimin e programit.
<b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Një pjesë e titujve të rinj që i janë shtuar fondit të bibliotekës kanë ardhur nëpërmjet projekteve të ndryshme kërkimore.
	GVJ u njoh me hapësirat e Bibliotekës në përdorim nga studentët.
	Biblioteka universitare është në dispozicion të studentëve dhe qëndron e hapur nga e hëna në të premte 8.00 – 16.00.
	Sallat e bibliotekës janë të mjaftueshme për studentët. Sipas informacionit të dhënë nga punonjësit, duket se studentët i përdorin më shumë këto ambiente gjatë sezonit të provimeve dhe detyrave.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

<b>Standardi IV.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Zyra e Studimeve dhe Studentëve (ZSS) funksionon brenda degës së Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional.</p> <p>ZSS ka përgjegjësinë e regjistrimit të studentëve dhe mbajtjen në formë shkresore dhe elektronike të bazës së të dhënave mbi studentët dhe rezultatet e tyre. ZSS plotëson të gjithë dokumentet individuale certifikuese mbi rezultatet e pjeshme ose të plota të studimeve dhe ruan dokumentacionin mbi ecurinë e procesit mësimor.</p> <p>Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore të institucionit, GVJ u njoh me regjistrat e studentëve në format elektronik dhe formë shkresore. Regjistri bazë kishte të dhënat mbi regjistrimin e studentëve, numrin e matrikullimit në përputhje me aktet nënligjore në fuqi; vlerësimet e marra gjatë ndjekjes së programit të studimit deri në diplomim, të dhëna për diplomën. Regjistri i notave mban të dhëna për vlerësimin e studenteve gjatë vitit.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrohet informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>UBT ka ndërtuar një sistem për menaxhimin e informacionit online bazuar mbi platformën ESSE3. Ky sistem menaxhon gjithë informacionin dhe dokumentet e stafit akademik, ndihmës e administrativ.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion u shqyrtua edhe dokumentacioni mbi personelin akademik, kryesisht mbi realizimin e procesit mësimor të programit në shqyrtim</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>ESSE 3 mundëson aksesin e informacionit nga gjithë stafi akademik dhe studentët e regjistruar. Ai jep informacion mbi programet e studimit si regjistrimin dhe lëvizjet (transferimet e tyre), faturimet, pagesat, menaxhimin e mësimdhënies, klasat, transkriptet e notave.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Sistemi lejon aksesimin dhe komunikimin nëpërmjet adresave të postës elektronike</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>GVJ testoi sistemin dhe rezultoi që ai garanton monitorimin në kohë reale të aktivitetit mësimor. Drejtuesit e institucionit apo personat e interesuar mund të nxjerrin raportime e të dhëna për procesin mësimor dhe aktivitetin akademik.</p>

<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Sistemi i menaxhimit të informacionit për momentin është vetëm në gjuhën shqipe. Ndërkohë, faqja e internetit të UBT ( <a href="http://ubt.edu.al/en_US/">http://ubt.edu.al/en_US/</a> ) ofron informacion të hollësishëm për institucionin dhe programet e studimit që ofrohen. Shumica e informacionit ofrohet në gjuhën shqipe.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

<b>Standardi IV.6</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Sipas dokumenteve të paraqitura në DVV, rezultojnë se UBT çdo vit paraqet një raport financiar. (Aneksi 50.1 Tabelë për të dhënat e financimit të programit të studimit 2014-2018 programi për DAME). Gjithashtu, plani i financimit të Programit të Studimit (Aneksi 50.), gjendja e përgjithshme e DAME-s dhe e vetë Fakultetit të Agronomisë dhe Mjedisit të jep të kuptosh se mbështetja financiare është e mirë dhe lejon mbarëvajtjen e një cikli të plotë studimi.
<b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.	<p>UBT ka përgatitur edhe një plan buxhet afatmesëm për periudhën 2016-2018.</p> <p>Në hartimin e buxhetit afatmesëm UBT ka theksuar se drejtimet kryesore të buxhetit janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Rritja e numrit të stafit akademik,</li> <li>• Mbështetja e kualifikimit të stafit brenda e jashtë vendit</li> <li>• Përmirësimi cilësor i laboratorëve shkencorë;</li> <li>• Përmirësimi i cilësisë së kërkimit shkencor nëpërmjet abonimit në revista shkencore dhe funksionimi i bibliotekës online;</li> <li>• Përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese dhe</li> <li>• Mbështetja e pjesëmarrjes në projekte, konferenca e kongrese kombëtare e ndërkombëtare.</li> </ul> <p>Përveç fondeve buxhetore, që mbulojnë kryesisht shpenzimet për paga dhe investime kapitale, UBT synon të rrisë të ardhurat nga njësitë në varësi të UBT. Këto të ardhura plotësojnë shpenzimet për stafin si dhe nevojat e tjera të institucionit në mbështetje të kërkimit shkencor.</p> <p>Por nga shqyrtimi i dokumentacionit të GVB del në pah se programi dhe DAME nuk kanë një buxhet të përcaktuar, ndonëse institucioni garanton se ka filluar puna për detajimin e tij në bazë të detyrimeve ligjore (Ligji 80/2015 „Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë“).</p>

<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Pranë UBT funksionon Zyra e Auditimit të Brendshëm. Në dokumentet e paraqitura në DVV nuk ka ndonjë raport auditimi të viteve të fundit.</p> <p>Raporti financiar i përmendur me sipër përmban të dhëna të hollësishme financiare mbi kostot dhe të ardhurat përfshirë tarifat e shkollimit dhe burimet e tjera financiare.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Në dokumentet e paraqitura në DVV gjenden :</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Buxheti 2016-2017-2018</li> <li>• Plani strategjik dhe vjetor nga Dega e Auditimit të Brendshëm</li> <li>• Pasqyrat e planit nga Dega e Auditimit të Brendshëm</li> <li>• Relacioni për Buxhetin afatmesëm 2016-2018</li> <li>• Relacioni për realizimin e buxhetit në 2015 dhe 2016</li> </ul> <p>Aneksi 50.1 Tabelë për të dhënat e financimit të programit të studimit 2014-2018 të programit për DAME, jep mundësi verifikimi të raportit financiar për vitet e përmendura por nuk parashikon planifikimin e ndërhyrjeve të posaçme përmirësuese të detajuara në nivel programi.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>Në dokumentet e paraqitura nuk ka të dhëna specifike mbi aktivitetin financiar lidhur me këtë program studimi. Burimi kryesor i financimit është buxheti i shtetit (70-75%) i plotësuar nga pagesat e studentëve dhe fondet e tjera të siguruar nga universiteti nga shërbimet ndaj të tretëve.</p> <p>Numri i lartë i studentëve në këtë program studimi garanton qëndrueshmërinë financiare të programit.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			✓	

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				✓



## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Procedurat për pranimin, përzgjedhjen dhe përparimin e studentëve janë të paracaktuara në Ligjin përkatës për Arsimin e Lartë dhe në disa Rregullore të UBT dhe vetë FBM (shih Anekset më poshtë).</p> <p>Politikat hartohen nga Rektorati i UBT në bashkëpunim të ngushtë me FBM.</p> <p>Vec kësaj në UBT është ngritur Zyra e Karrierës së Studentëve (ZKS) si pjesë e Qendrës së Karrierës dhe Alumni (QKA) në varësi të Degës së Informacionit dhe Transferimit të Njohurive. ZKS informon dhe orienton studentët për pranimet në programet e studimit dhe ndjek ecurinë e studentëve deri në diplomim.</p> <p><b>Anekset</b></p> <p>5.1. Rregullorja e studimeve UBT 2017</p> <p>6.1 Rregullore e brendshme e FBM 2017</p> <p>7.1 Rregullore Programit të Studimeve Universitare_BSc.Inxhinieri Agromjedisi</p> <p>9.1 Rregullore e DZHKKVI dhe DITNJ_2017</p> <p>9.2. Rregullore e ZSS</p> <p>10.1 Rregullore e diplomimit</p> <p>14.4 Kriteret e pranimet ne FBM.</p> <p>17.1 Studimi i tregut të punës për programin Inxhinier i Agromjedisit</p> <p>36. Manual si regjistohen studentët.</p> <p>37. Manuali i Cilësisë.</p> <p>51.1 Politika e marketing-ut të programit të studimit, format e tij, transparenca me publikun</p> <p>52.1 Procedura për ndryshimin e Kurrikulës dhe</p> <p>61. Rregullore e zyrës/njësisë së këshillimit dhe karrierës.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Rregulloret e mësipërme garantojnë barazi në informacion dhe në të drejta për të gjithë studentët bazuar vetëm në rezultatet e tyre akademike.</p> <p>Rregulloret e mësipërme nuk përmbajnë kritere diskriminuese apo përjashtuese për grupe të caktuara studentësh.</p> <p>ZKS duket se është e hapur dhe ofron shërbimet të njëjta për të gjithë studentët.</p> <p>Studentët kanë akses të barabartë në informacionet lidhur me programin e studimit gjë që realizohet nëpërmjet faqes së internetit të UBT dhe sistemit (ESSE3).</p>

	Studentët, në takimin e zhvilluar me ta, u shprehen të kënaqur me mënyrat e ofrimit të informacionit dhe shërbimeve.
<b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	<p>Kriteret e pranimit dhe procedurat e avancimit në programin e studimit bazohen vetëm në rezultatet akademike dhe plotësimin e kërkesave të procesit mësimor (pjesëmarrje në seminare, realizimi i detyrave e projekteve të kursit) në përputhje me Aneksin 14.4 Kriteret e pranimit ne FBM si dhe në rregulloret e paraqitura më poshtë.</p> <p>Kandidatët për studentë informohen nga ZKS nëpërmjet broshurave, takimeve apo internetit mbi kriteret dhe procedurat e pranimit, përmbajtjen e programit të studimit dhe mundësitë për punësim apo karrierë akademike. Metodot e vlerësimit të dijeve bëhen publike nga pedagogët përkatës në faqen e internetit. Studentët gjatë takimit u shprehen se informacioni ofruar është i mjaftueshëm dhe i dobishëm.</p> <p>Të gjitha kriteret dhe procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë të shpjeguara në aktet rregullore të mëposhtëme</p> <p><b>Anekset</b></p> <p>6.1 Rregullore e brendshme e FBM 2017</p> <p>7.1 Rregullore Programit te Studimeve Universitare _BSc.Inxhinieri Agromjedisi</p> <p>9.1 Rregullore e DZHKKVI dhe DITNJ_2017</p> <p>9.2. Rregullore e ZSS</p> <p>10.1 Rregullore e diplomimit</p> <p>14.4 Kriteret e pranimit ne FBM.</p> <p>36. Manual si regjistrohen studentet.</p> <p>61. Rregullore e zyrës/njësisë së këshillimit dhe karrierës,</p>
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.	<p>Kriteret e vecanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve janë përcaktuar në Aneksin 14.4. Kriteret e pranimit ne FBM dhe në Aneksin 7.1 Rregullore Programit të Studimeve Universitare BSc. Inxhinieri Agromjedisi.</p> <p>Kriteret për pranimin e studentëve në ciklin e parë të studimeve në Inxhinieri Agromjedisi publikohen dhe në faqen on-line të UBT-së si dhe nëpërmjet ZKS të FBM.</p>
<b>Kriteri 5.</b> Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	<p>Kriteret e përgjithshme dhe specifike hartohen në përputhje me aktet nënligjore të MASR.</p> <p>Pranimi në programet e studimit “Bachelor” të FBM-së, bëhet sipas udhëzimeve dhe kuotave të përcaktuara në aktet nënligjore përkatëse që nxjerr Këshilli i Ministrave apo MASR për vitin akademik përkatës.</p> <p>Kriteret përcaktojnë dhe pranimin e studentëve të huaj me kusht që të kenë kryer ekuivalentimin e diplomës.</p>
<b>Kriteri 6.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje	UBT përgatit, para fillimit të çdo viti shkollor, materiale promovuese për programet e studimit që ofron.

me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	ZKS zhvillon takime informuese me studentët, takime të cilat janë më shumë orientuese duke marrë në konsideratë edhe dëshirat dhe synimet që kanë studentët e ardhshëm. Të gjitha informacionet publikohen edhe në faqen e internetit të UBT. Megjithatë duket se politikat e marketingut nuk janë proaktive bazuar ndoshta në kërkesën e lartë për programin BSc. Inxhinieri Agromjedisi.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

**Standardi V.2**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Informimi i studentëve mbi kriteret dhe procedurat e avancimit akademik kryhet nëpërmjet sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit (ESSE3). Ky sistem siguron akses on-line të studentëve pavarësisht vendndodhjes dhe kohës. Nëpërmjet këtij sistemi, ata informohen mbi detyrat e kursit, punët laboratorike, provimet, përparimin akademik, kalimin nga një vit akademik në tjetrin dhe detyrime të tjera. I gjithë ky informacion shpërndahet edhe nëpërmjet e-mailit ose mund të gjendet në vetë faqen e pedagogëve të lëndëve përkatëse. Sa më sipër u verifikua nga vetë GVJ si dhe nga biseda me studentët e programit në shqyrtim.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Studentët informohen lidhur me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme, kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve dhe kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit nëpërmjet zyrave përkatëse (ZSS), sistemit të menaxhimit të informacionit dhe sekretarisë së DAME.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Kriteret dhe procedurat përcaktohen në aktet rregullatore të brendshme si në Rregulloren e studimeve universitare, Rregulloren e Brendshme të FBM, Rregulloren e sekretarisë mësimore (ZSS) dhe Rregulloren e programit të studimit në Inxhinieri Agromjedisi.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Në shumicën e rasteve punimi i diplomës kryhet nëpërmjet provimit përfundimtar formues. Ky provim jepet në përfundim të programit të studimit.
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	GVJ u informua se ZKS, FBM dhe UBT përgatisin, para fillimit të çdo viti shkollor, materiale promovuese për programet e studimit që ofrojnë. Materialet shpërndahen jo vetëm në Tiranë por edhe në rrethe. Gjatë gjithë vitit ZKS informon studentët e rinj dhe i orienton ata në lidhje me programin e studimit në Inxhinieri Agromjedisi. Të gjitha informacionet publikohen edhe në faqen e internetit të UBT.

	Përgjegjësi i ZKS-së njohu GVJ me fletëpalosjet specifike për programin Inxhinieri Agromjedisit. Informacione të tjera mbi programin e studimit publikohen në faqen zyrtare Ëeb të DAME-s FBM-së dhe UBT-së.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				✓

**Standardi V.3**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Zyrat e Sekretarisë dhe ZSK informojnë studentët për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit, përmbajtjen e lëndëve dhe moduleve apo veprimtarive formuese. Të gjitha rregulloret përkatëse janë të publikuara online dhe gjenden në:  6.1 Rregulloren e brendshme e FBM 2017  7.1 Rregulloren e Programit të Studimeve Universitare_BSc.Inxhinieri Agromjedisi  10.1 Rregulloren e diplomimit  14.4 Kriteret e pranimit ne FBM.  Gjithashtu studentët informohen edhe nëpërmjet sistemit të brendshëm të menaxhimit të informacionit apo faqeve personale të pedagogëve në internet.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	GVJ u informua nga Qendra e Karrierës dhe Alumni për organizimin e përvitshëm pranë UBT-së të Panairit të Karrierës së Studentëve. Në panair ftohen të marrin pjesë institucione shtetërore dhe ndërmarrje private të cilat mund të ofrojnë punësim për studentët. Gjithashtu, QKA informoi se ofron këshillim dhe orientim në tregun e punës për studentët e interesuar. UBT dhe FBM kanë marrëveshje me një sërë institucionesh dhe entesh private e shtetërore për të nxitur punësimin e studentëve. Pedagogët e modulit menaxhim karriere ofrojnë orientim të vazhdueshëm për studentët në tregun e punës.  Megjithatë panairi duhet të jetë më gjithpërfshirës dhe të krijohen më shumë lidhje me tregun privat të interesuar për të punësuar studentë të këtij programi.
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	FBM vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit në Inxhinieri Agromjedisi informacione të shumta dhe të përditësuara mbi zhvillimin e procesit mësimor, mbi logjistikën dhe infrastrukturën mbështetëse dhe shërbimet që kryhen në funksion të realizimit të këtij program studimi. Ky informacion ofrohet nga ZKS dhe sistemi i

<p><b>Kriteri 5</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.</p>	<p>menaxhimit të informacionit si dhe sekretarisë së departamentit të Agromjedisit dhe Ekologjisë,</p> <p>Të dhëna mbi zhvillimin e procesit mësimor, mbi logjistikën dhe infrastrukturën mbështetëse të programit të studimit në Inxhinieri Agromjedisi publikohen edhe në udhëzues të posaçëm, në takime me studentët nga përgjegjësi i departamentit dhe në formën e rregulloreve, në faqen ëeb të UBT-së.</p> <p>I gjithë ky informacion gjendet lehtësisht on-line dhe është i arritshëm nga studentët pavarësisht vendndodhjes së tyre.</p> <p>Në takimin me studentët u konfirmua se ata janë të mirëinformuar mbi zhvillimin e procesit mësimor dhe infrastrukturën mbështetëse të programit të studimeve në Inxhinieri Agromjedisi.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				✓

#### Standardi V.4

**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.</p>	<p>Statistikat vjetore për numrin e studentëve mbahen në zyrën e Sekretarisë Mësimore.</p> <p>GVJ kontrolloi regjistrat e studentëve të programit të studimit në shqyrtim ku janë regjistruar të gjithë studentët që ndjekin programin apo të diplomuar ndër vite.</p> <p>Nga kqyrja e këtyre rregjistrave, rezulton sa më poshtë:</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Viti akademik 2016-2017 Janë regjistruar 96 studentë për herë të parë në vitin e parë. Nga këta, 1 student është larguar. Kanë frekuentuar mësimin 95 studentë. Një student është i pa matrikulluar;</p> <p>Viti akademik 2017-2018 Janë regjistruar 131 studentë për herë të parë në vitin e parë. Nga këta janë larguar 4 studentë. Kanë vijuar studimet 127 studentë. Të gjithë janë të matrikulluar</p> <p>Viti akademik 2018-2019 Janë regjistruar 130 studentë për herë të parë në vitin e parë. Në këtë vit akademik asnjë student nuk është larguar. Ndërsa 3 studentë janë pa matrikulluar</p> <p>Studentë gjithsej të regjistruar për herë të parë në programin Bsc në të tre vitet e fundit akademike janë 352 studentë.</p>



<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Sekretaria Mësimore disponon regjistrat e notave të studentëve sipas lëndëve të programit të studimit, të dhëna për temat e diplomave dhe rezultatet e diplomimit të studentëve që kanë përfunduar këtë program studimi.</p> <p>GVJ u njoh me regjistrat dhe verifikoi materialin shkresor për disa nga studentët e zgjedhur në mënyrë rastësore.</p> <p>Informacionet lidhur me mesataren e përgjithshme gjenden në Aneksin 27.3_ZSS_Mesataret e studenteve në perfundim të studimeve 2014-2018</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Sistemi i brendshëm i menaxhimit të informacionit përmban edhe të dhënat statistikore të studentëve.</p> <p>Të dhëna janë lehtësisht të aksesueshme për personat e autorizuar e të regjistruar në sistem. Hyrja në sistem kryhet nëpërmjet përdorimit të emrit të përdoruesit dhe fjalëkalimit të autorizuar për të aksesuar të dhënat.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Sekretaria mësimore, bazuar në të dhënat e administruara harton raporte statistikore sipas nevojave të fakultetit apo universitetit përfshirë cilësinë e studentëve që mbarojnë studimet.</p> <p>Zyra e karrierës përmbledh të dhënat mbi punësimin e studentëve që kanë mbaruar programin e studimit dhe mundohet të ndjekë ecurinë e karrierës së tyre për aq sa është e mundur.</p> <p>Megjithatë ky informacion nuk u verifikua dot në raportet bashkëngjitur në materialin e dorëzuar nga GVB.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				✓

### Standardi V.5

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Përfshirja e studentëve në organet vendimmarrëse e këshilluese të UBT sanksionohet në rregulloret e paraqitura nga institucioni:</p> <p>5.1. Rregullorja e studimeve UBT 2017</p> <p>6.1 Rregullore e brendshme e FBM 2017</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me</p>	<p>7.1 Rregullore Programit të Studimeve Universitare_BSc.Inxhinieri Agromjedisi</p> <p>Përfaqësuesja e studentëve ishte pjesë e GVB dhe e pranishme në takime. Po kështu, gjatë takimit me studentët ata u shprehën se e njohin përfaqësuesen e tyre në Senat ndonëse një pjesë e mire ishte e painformuar lidhur me aktivitetin e përfaqësueses në këtë forum.</p>

rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.									
<b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	Programi i studimit ka një shpërndarje thuajse uniforme të ngarkesës në semestra të ndryshëm gjatë ciklit të studimit. Procedurat e përparimit dhe njohjes së studimeve të mëparshme janë të hapura e të njohura nga të gjithë studentët. Sipas studentëve ngarkesa e lëndëve është në përpjesëtim të drejtë me numrin e krediteve. Studentët nuk paraqiten ndonjë ankese për procedura burokratike e të tejzgjatura.								
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.	Rregulloret e institucionit garantojnë përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit. Megjithatë si raporti i GVB ashtu diskutimet në takimet e mbajtura në FBM dhe DAME nuk paraqitën të dhëna dokumentuese të përfshirjes konkrete të studentëve. Po kështu nuk duket se në institucion ekziston një një kanal formal ankimi në dispozicion të studentëve. Studentët u shprehen se arrijnë ti adresojnë shqetësimet e tyre direkt me pedagogët apo me drejtuesin e departamentit e fakultetit nëse është e nevojshme.								
<b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Përveç sa më sipër, institucioni kryen anketime të rregullta të studentëve dhe mundohet të reflektojë sugjerimet e tyre. Nëpërmjet këtyre anketimeve studentët shprehen edhe mbi ndershmërinë dhe barazinë në procesin e vlerësimit të dijeve.								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>✓</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			✓	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		✓							

**Standardi V.6**

**Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Zyra e Studimeve dhe Studentëve (ZSS), në varësi të Degës së Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional, është në shërbim të studentëve dhe ofron informacione të nevojshme lidhur me ecurinë e tyre në procesin mësimor.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Sistemi i menaxhimit të informacionit ESSE3 është i ngritur dhe funksional. Ai garanton informacionin e nevojshëm për studentët. Gjithashtu, pedagogët dhe drejtuesit e departamentit ofrojnë drejtpërdrejtë mbështetje dhe udhëzime për studentët sipas kërkesave apo nevojave të studentëve.

<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Qendra e Karrierës dhe Alumni siguron mbështetje për studentët lidhur me procesin mësimor dhe programin e studimit si dhe jep orientime për karrierën e mëtejshme.</p> <p>Në lidhje me praktikën profesionale, QKA ndikon që studentët të kryejnë internship apo praktikë profesionale në qendra me mundësi punësimi në të ardhmen.</p> <p>QKA organizon Panairin e Karrierës së Studentëve, duke siguruar pjesëmarrje të institucioneve, sipërmarrjeve dhe organizatave të ndryshme dhe përpilon raportin lidhur me Panairin të cilin jua vë në dispozicion studentëve dhe autoriteteve drejtuese.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Sipas të dhënave të referuara gjatë takimit me QKA, kjo zyrë mundohet të mbledhë të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e diplomimit të studentëve. Megjithatë rezulton se të dhënat janë të pakta.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">✓</p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">✓</p>
--	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	---

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

<p><b>Standardi VI.1</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p> <p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p> <p>Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë mbështetet në statutin e UBT, Rregulloret përkatëse të miratuara dhe në Manualin e Cilësisë. Manuali hartohet dhe përditësohet rregullisht nga Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional që është pjesë e Degës së Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional së UBT-së. Të gjitha ndryshimet apo përditësimet i paraqiten Komisionit të Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë, Programeve të Studimit dhe Kërkimit Shkencor të Universitetit dhe miratohen nga Senati Akademik.</p> <p>Aktet që rregullojnë sigurimin e cilësisë paraqiten më poshtë:</p> <p><b>Anekse</b></p>



	<p>5.1. Rregullorja e studimeve UBT 2017</p> <p>6.1 Rregullore e brendshme e FBM 2017</p> <p>7.1 Rregullore Programit të Studimeve Universitare_BSc.Inxhinieri Agromjedisi</p> <p>9.2. Rregullore e ZSS</p> <p>37. Manuali i Cilësisë.</p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Njësia e Sigurimi të Brendshëm të Cilësisë është përgjegjëse për respektimin e standardeve të cilësisë në gjithë programet e studimit të UBT. Ajo bashkëpunon me fakultetet dhe departamentet për vlerësimin periodik të programeve mësimore, cilësinë e mësimdhënies dhe kërkimin shkencor. Pyetësi për studentët që realizohet çdo fund semestri është një nga instrumentet e përdorur për sigurimin e cilësisë.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Sikurse thënë më lartë Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë mbështetet në statutin e UBT, Rregulloret përkatëse të miratuara dhe në Manualin e Cilësisë.</p> <p>Sigurimi i jashtëm i cilësisë udhëhiqet nga ASCAL e cila ndjek procedurat për vlerësimin jashtëm të cilësisë nëpërmjet akreditimit të Institucionit dhe të programeve që ofron Institucioni.</p> <p>Tashmë është përfunduar akreditimi institucional i UBT-se. Programi i studimit "Bachelor" në Inxhinieri Agromjedisi po i nënshtrohet procesit të akreditimit për herë të parë.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Siç kemi përmendur më sipër institucioni ka hartuar dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë. Raporti vjetor i monitorimit analizon cilësinë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor të realizuar në të gjitha njësitë bazë. Ai vlerëson preferencën e stafit akademik, gjendjen dhe cilësinë e infrastrukturave e pajisjeve, funksionimin e zyrave mbështetëse (ZSS, QKA), financimin e qëndrueshëm të programeve të studimit, ngarkesën e stafit dhe nevojat për rekrutime, etj. Raporti i hartuar në bazë departamenti, fakulteti e universiteti, garanton përfshirjen e gjithë njësive përbërëse dhe aktorëve të brendshëm.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

### Standardi VI.2

**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin,</p>	<p>Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë mbështetet në statutin e UBT, Rregulloret përkatëse të miratuara dhe në Manualin e Cilësisë. Në UBT është krijuar Zyra</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.	<p>e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional që është pjesë e Sektorit të Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional (SZhKKVI) së UBT-së.</p> <p>SZhKKVI është njësi e posaçme përgjegjëse për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen dhe rishikimin e programit të studimit.</p> <p>Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë, Programeve të Studimit dhe Kërkimit Shkencor në nivel universiteti i raporton senatit mbi vlerësimin dhe rishikimin e programeve të studimit.</p> <p>Komisioni për Sigurimin e Cilësisë së Programit të Studimit dhe Kërkimit Shkencor në fakultet shqyrton paraprakisht propozimet për ndryshimin/rishikimin e kurrikulave dhe programit mësimor. Departamenti është përgjegjës për përgatitjen e propozimeve për ndryshimin e kurrikulave.</p>			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.	<p>Në dokumentet e paraqitura në DVV, rezulton se institucioni përdor procedura formale e të dokumentuara për shqyrtimin dhe miratimin e programeve të studimit. Procedura fillon me propozimin e departamentit, shqyrtimin nga komisioni i posaçëm, kalimin nëpërmjet dekanit dhe rektorit në Senatit e UBT për miratim.</p> <p>Sipas nenit 91 të Rregullores së Brendshme të FBM (2017), Fakulteti organizon në fund të çdo viti akademik rishikimin periodik të programit të studimit dhe rregullores mësimore të tij nëpërmjet një komisioni ad-hoc.</p>			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	<p>Instrumentet e përdorur për vlerësimin e cilësisë përfshijnë anketimet dhe pyetësorët për studentët, formularin e vlerësimit të performancës së stafit akademik, inspektimet gjatë zhvillimit të procesit mësimor, vlerësimin e detyrave dhe provimeve të studentëve dhe kontrollin e plotësisht të ngarkesës mësimore dhe akademike.</p> <p>Procedurat përshkruhen në mënyrë të detajuar në dokumentin e titulluar "Manuali i Cilësisë" (Aneks 37.1)</p>			
<b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	<p>Raportet periodike të vlerësimit i paraqiten Dekanit, Rektorit dhe diskutohen në Senatit e UBT, i cili miraton planin e masave për adresimin e problemeve të evidentuara. Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë, Programeve të Studimit dhe Kërkimit Shkencor publikon raportet vjetore për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë.</p>			
<b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.	<p>Raportet e vlerësimit janë vjetore. Raportet përfshijnë rezultatet e vlerësimit dhe masat që duhet të merren për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë.</p> <p>Megjithatë, raportet nuk respektojnë kryekëput periodicitetin dhe strukturën e kërkuar të përbërë nga rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
<b>Standardi VI.3</b>			✓	

**Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve								
<b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	Raporti i Vetëvlerësimit është hartuar në 2014 (Aneks 18.2 Raporti i Vetëvlerësimit DAME 2014). Ky raport është i përfshirë në dokumentacionin mbështetës për akreditimin e programit.								
<b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.	FBM përdor metoda të ndryshme për vlerësimin e cilësisë ku përfshihen: (i) metodat e drejtpërdrejta si inspektimet gjate zhvillimit të procesit mësimor, vlerësim paralel të detyrave dhe provimeve të studentëve, vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve apo praktikës profesionale; dhe (ii) metoda të tërthorta si kontrolli i plotësimit të ngarkesës mësimore e akademike, anketimet dhe pyetësorët për studentët, formularin e vlerësimit të performancës së stafit akademik dhe diskutime me institucionet partnere.								
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.									
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.									
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Suk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>✓</td> </tr> </tbody> </table>	Suk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				✓
Suk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			✓						

**Standardi VI.4**

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë	DAME ka kryer një vetëvlerësimin të brendshëm lidhur me ecurinë e procesit mësimor, kërkimor dhe cilësinë. Raporti i Vetëvlerësimit të

përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	DAME (2014) është i vetmi raport vetëvlerësimi vënë në dispozicion të GVJ-së. Raporti i është dërguar FBM për të hartuar raportin në nivel fakulteti. Duket se raporti i vetëvlerësimit nuk është i përvitshëm dhe nuk përfshin aktorë të tjerë përvec DAME dhe FBM.			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Manuali i cilësisë dhe rregulloret e funksionimit të Njësisë për Sigurimin e Brendshëm të cilësisë përcaktojnë përgjegjësitë dhe detyrat e gjithë strukturave dhe individëve në raport me procesin e sigurimit të cilësisë së programit të studimit, përfshirë edhe studentët. Rregulloret e sipërpërmendura garantojnë përfshirjen e aktorëve të brendshëm (stafi akademik, ndihmës e studentet) pa dallime e diskriminime dhe në respekt të integritetit akademik.			
<b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.				
<b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.				
<b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyer në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Vetë programi ka përfituar nga shkëmbimi i eksperiencës me institucione të huaja dhe në vecanti më Institutin Kombëtar Politeknik të Lorenës (Institut National Polytechnique de Lorraine, Nancy, France). NRVB dëshmon përfshirjen e ekspertëve të jashtëm në përmirësimin e cilësisë së laboratorit shkencor i cili është pjesë përbërëse e rëndësishme e DAME-s. Ky laborator është mbështetur nga projekti Konsolidimi i Sistemit të Monitorimit Mjedisor në Shqipëri (CEMSA) i Bashkimit Europian, nga ekspertiza e Institutit Kombëtar Politeknik të Lorenës dhe nga bashkëpunimi më Univeritetin e Gissen (Justus Liebig University Giessen) në Gjermani.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			✓	

**Standardi VI.5**

**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike	Të gjitha dokumentet që lidhen me sigurimin e brendshëm të cilësisë (manuale, rregullore, vendime) në UBT janë bërë publike nëpërmjet publikimit në faqen eeb të UBT-së. Dokumentet janë të aksesueshme dhe GVJ pa disa prej tyre gjatë vizitës. Studentët, stafi akademik dhe

për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	ndihmës kanë akses në këtë dokumentacion dhe mund të marrin gjithë informacionin e duhur mbi proceset e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Raportet e vlerësimit gjenden lehtësisht on-line dhe mund të shikohen nga publiku. Raportet bëhen publike sipas përcaktimeve në rregullore duke respektuar etikën akademike dhe përcaktimet ligjore për të dhënat personale.			
<b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Raportet e vetëvlerësimit janë shoqëruar me rekomandime dhe masa që trajtojnë mangësitë. Ky plan (Aneksi 4.3: Plani i masave, për Mirëfillimin dhe Mirëvijimin e Vitit Akademik 2018-2019.) është miratuar nga Rektorati i UBT-së.			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	GVB pati mundësinë të vlerësonte se një pjesë e mirë e masave të parashikuara në Plani i masave, për Mirëfillimin dhe Mirëvijimin e Vitit Akademik 2018-2019 (aneks 4.3) janë përmbushur duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit ka organizuar herë pas here aktivitete si me stafin akademik e ndihmës ashtu edhe me studentët për ti informuar dhe ndërgjegjësuat ata lidhur me procesin dhe rezultatet e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programeve të studimit.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

## Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor “Inxhinieri Agromjedisit”

### Pikat e forta dhe afirmime

1. Njësia bazë për zbatimin e këtij programi mësimor, Departamenti i Agromjedisit dhe Ekologjisë (DAME) ka përvojë 20 vjeçare në fushën e veprimtarisë me personel akademik dhe ndihmës të konsoliduar, me kohë të plotë, dhe mjedise e infrastrukturë të mjaftueshme.
2. DAME dhe Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit ka personel akademik të kualifikuar në dispozicion të realizimit të programit të studimit, i përfshirë në fusha të kërkimit shkencor sipas fushës së veprimtarisë dhe fokusit të programit të studimit.
3. Fusha e veprimtarisë është prioritare për vendin tonë me kërkesa në rritje për specialistë të mjedisit dhe të bujqësisë në drejtimin e menaxhimit të burimeve. UBT ka luajtur dhe luan rol drejtues unik në ofrimin e specialistëve të kësaj fushe.
4. Programi është i strukturuar në përputhje të plotë me kuadrin ligjor kombëtar në fuqi. Struktura e programit është e mjaft e ekuilibruar midis lëndëve të përgjithshme bazë dhe atyre të specialitetit. Shpërndarja e krediteve gjatë viteve dhe ndërtimi i programit mundëson shkëmbimin e studentëve ndërmjet programeve të tjera brenda institucionit dhe përfshirjen e tyre në programe shkëmbimi jashtë vendit.
5. DAME ka mundësi aplikimi në praktikë të njohurive që u ofron studentëve në pjesën teorike të programit të studimit përmes infrastrukturës laboratorike apo eksperimentale në terren. DAME është ndër të vetmit institucione në Shqipëri me laborator të akredituar për analizat e tokës dhe të ujit (Laboratori Shkencor i Mjedisit).
6. DAME ka vendosur një bashkëpunim i mirë me institucionet qendrore që merren me çështjet e bujqësisë dhe mjedisit. Këto bashkëpunime përfshijnë institucione kryesore të vendit që mundësojnë përthithjen e studentëve të këtij programi në punësim pas përfundimit të studimeve.
7. DAME ka vendosur një bashkëpunim të mirë me institucionet simotra jashtë vendit duke përfituar përvojë dhe duke siguruar kualifikim të mëtjshëm të stafit dhe të studentëve.
8. DAME ofron kurse specializimi dhe studime të nivele më të larta (cikël i nivelit të dytë) në disa drejtime studime, që krijon mundësi për avancimin e mëtjshëm profesional të studentëve të diplomuar në këtë program studimi të ciklit të parë.

### Pika të dobëta

1. Mungesë e një plani buxhetor të qartë për të rritur cilësinë e programit dhe mundësi të kufizuara financiare për mbështetjen e praktikave profesionale të studentëve.
2. Ngarkesa e madhe mësimore e stafit akademik në disa programe studimi paralele ndikon në mbështetjen dhe ndërveprimin e gjerë më studentët e ciklit të parë të studimit.

3. Baza materiale dhe pajisjet në laboratorët ekzistues mësimorë mundëson vetëm punë demonstrative apo në grupe të studentëve duke kufizuar aftësimin e tyre praktik në tematika të ndryshme të lëndëve të programit të studimit.
4. Përdorimi i teknologjive të informacionit në menaxhimin e provimeve dhe të të dhënave të tjera në ndihmë të studentëve
5. Mungesë politikash proaktive të marketingut, vlerësim i kufizuar i tregut të punës dhe gjurmim i pamjaftueshëm i punësimit të studentëve të diplomuar

### Rekomandime

1. FBM duhet të hartojë një plan buxhetor specifik për të rritur cilësinë e programit. Ky plan duhet të konsiderojë si prioritarë shtimin e ditëve për praktikat profesionale të studentëve duke u mundësuar më shumë vizita në terren dhe një njohje më të mirë të problematikës së Mjedisit. Plani duhet të miratohet dhe monitorohet në organet vendimmarrëse të UBT.
2. Pajisja me mjete dhe aparate dhe zgjerimi i punës në laboratore dhe praktikat mësimore do të përforcojë më tej njohuritë e studentëve, duke i bërë ata më të përgatitur për tu futur në tregun e punës.
3. Zhvillimi i mëtejshëm i kurrikulës së studimit bazuar në një studim më të plotë të segmenteve të tregut të punës që përthithin studentë të këtij programi studimi.
4. Shtrirja e gjurmimit të studentëve me mënyra shtesë do të japë informacion edhe mbi fokusimin dhe shtjellimin më të gjerë të lëndëve të vecanta, duke krijuar mundësi për të nxjerrë specialistë më të thelluar në njohuritë dhe aftësitë praktike të tyre.
5. Zgjerimi i shërbimeve për studentët (futja e softëareve të vecantë) do të lehtësojë shkëmbimin e informacionit, vlerësimin on line, etj.
6. Marketingu i deritanishëm ka nevojë të rritet ndjeshëm në masë dhe në formë. Marketingu duhet të prekë të gjithë tregun e punës dhe qasja duhet të jetë më proaktive. Panairi mund të zgjerohet ndërkohë që formate on-line të marketingut mund të përdoren gjerësisht.

### SWOT analyses for the Study program: Bachelor “Agroenvironmental Engineering” of Tirana Agricultural University (TAU)

#### Strengths and affirmations

1. The main unit for the implementation of this study program, the Department of Agro-Environment and Ecology (DAEE) has 20 years of experience in the field of activity with a full-time academic staff and consolidated assistants, and also sufficient facilities and infrastructure.

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

2. DAEE and the Faculty of Agriculture and Environment (FAE) has a qualified academic staff available to carry out the study program, involved in fields of research according to the field of activity and the focus of the study program.
3. The field of activity is a priority for Albania with growing demands for environmental and agriculture specialists in managing resource management. TAU has played and still plays a unique leading role in providing specialists of this field.
4. The program is structured in full compliance with the national legal framework in force. The structure of the program is quite balanced between general and special subjects. The distribution of credits over the years and the structure of the program enables the exchange of students between other programs within the institution and their involvement in exchange programs abroad.
5. DAEE has the opportunity to apply in practice the knowledge offered to the students in the theoretical part of the study program through laboratory or experimental field infrastructure. DAEE is one of the only institutions in Albania with an accredited laboratory for soil and water analysis (Research Lab of Environment).
6. DAEE has established a good cooperation with central institutions dealing with agriculture and the environment. These collaborations include key institutions in the country that enable students of this program to have an opportunity of employment after graduation.
7. DAEE has established a good cooperation with sister institutions abroad gaining experience and providing further qualification of the staff and students.
8. DAEE offers specialization courses and higher level studies (second level cycle) in several study directions, which creates opportunities for further professional advancement of the graduate students in this first cycle of this study program.

### Weaknesses

1. Lack of a clear budget plan to increase program quality and financial constraints for the support of professional practices of the students.
2. The teaching workload of the academic staff in several parallel study programs impacts the support and interaction with students of the first cycle of study.
3. The material and equipment base in the existing teaching labs enables only demonstrative work or in groups of students, this way limiting their practical training in different subject areas of the study program subjects.
4. Use of information technologies in exam management and other data to help students.
5. Lack of proactive marketing policies, limited labor market assessment and insufficient employment tracking for graduate students.



**Recommendations**

1. FAE should develop a specific budget plan to enhance the quality of the program. This plan should consider as a priority the addition of days for professional student practices by enabling more on-site visits and a better understanding of environmental issues. The plan should be approved and monitored from the TAU decision-making bodies.
2. Equipment with tools and appliances and expanding work in laboratories and teaching practices will further strengthen student knowledge, making them more prepared to enter the labor market.
3. Further development of the study curriculum based on a more comprehensive study of the labor market segments which absorb students of this study program.
4. The extension of tracking of students with additional resources will also provide information on focusing and broader coverage of specific subjects, creating opportunities to attract more in-depth specialists to their knowledge and practical skills.
5. Expanding student services (introducing special softwares) will facilitate information exchange, on-line evaluation, etc.
6. So far, marketing needs to grow significantly in bulk and shape. Marketing should touch the entire labor market and access should be more proactive. The fair can be expanded while on-line marketing formats can be widely used.

## Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Ngj. përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				✓
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				✓
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				✓
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				✓
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				✓
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				✓
VLERËSIMI TËRËSOR				✓

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof As. Mihallaq Qirjo
2. Dr. Taulant Bino